



Studimet pasdiplomike-cikli i dytë

Tezë Masteri

“Vlerësimi i gjendjes dhe performancës financiare nga perspektiva e vendimmarrjes menaxheriale: Rasti i “Molika Vigjilent, sh.p.k” Tetovë për periudhën 2012-2016”

Kandidati:
Shkëlqim Rexhepi

Mentori:
Prof. Inord. Dr. Fitim Deari

Tetovë, tetor, 2020

LËNDA E HULUMTIMIT

Analiza financiare paraqet përzgjedhjen, vlerësimin dhe interpretimin e të dhënave financiare bashkë me informacione të tjera përkatëse dhe përcjellëse që të ndihmojnë në investime/financime, pra në marrjen e vendimeve menaxheriale. Analiza financiare mund të shtrihet për të vlerësuar çështje sikurse është performanca e punëtorëve, efikasiteti dhe efektiviteti i funksioneve apo operacioneve të ndërmarrjes apo politikën e kreditit. Një detyrë e rëndësishme e analistit financiar është edhe vlerësimi i investimeve potenciale/reale, aftësisë kreditore të huamarrësve, etj.

Instrumentet që përdoren për të analizuar, krahasuar dhe interpretuar pasqyrat financiare apo informacionin financiar përgjithësisht janë disa, por të zakonshëm janë treguesit financiarë/raportet financiare, që janë vegël e analizës financiare. Raport nënkupton relacion matematikor ndërmjet një sasive ndaj një tjetre, ndërsa raporti financiar është krahasimi në mes një informacioni financiar me një tjetër dhe si të tillë ato janë mjaft tërëndësishëm në analizat vendimmarrëse. Andaj, analiza e raporteve financiare paraqet mënyrën e drejtë për të vlerësuar performancën e një kompanie, kuptohet duke gërshetuar informacionin e fituar më informacion brenda dhe jashtë biznesit.

Bërja e një investimi është vendim shumë i madh dhe mjaft kompleks, sidomos në rastin e atyre afatgjata. Investimi është angazhimi aktual i pasurisë së dikujt për një periudhë kohore të caktuar për të bërë tërëtur pasurinë (Reilly, 1989: 5-6). Ndërkohë, një vendim i keq gjatë investimit mund të çojë investitorët në humbje. Për këtë arsye duhet të analizohet me kujdes norma e kthimit dhe riskut përkatës, performanca e kaluar e kompanisë, pozita e konkurrentit, situata e përgjithshme e tregut dhe shumë faktorë të tjerë që mund të ndikojnë investimet. Të gjitha këto më së miri analizohen me ndihmën e raporteve financiare si dhe krahasimin e pasqyrave financiare, në përgjithësi me analizën financiare apo me theks të veçantë me analizën e pasqyra financiare.

Andaj, në këtë punim do të përdoren një sërë teknikash për të analizuar gjendjen dhe performancën për rastin studimor duke pretenduar kështu të nxirren disa implikime afariste. Do të shërbehem me pasqyrat financiare të firmës “Molika Vigjilent, sh.p.k.” Tetovë. Firma në fjalë përgatitë dy lloje të pasqyrave financiare që janë bazë, bilancin e gjendjes dhe pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve (bilancin e suksesit).

Do të analizohen pasqyrat financiare dhe raportet financiare për periudhën 2012 – 2016. Kjo periudhë është zgjedhur nga fakti se paraqet periudhën para dhe pas investimit, ku investimi është bërë në vitin 2014, pasi që neve na intereson ndikimi i investimit në performancën financiare të dy ndërmarrjeve dhe sa i leverdishëm ka rezultuar ky investim i bërë nga firma “Molika Vigjilent, sh.p.k.” Tetovë.

HIPOTEZAT

Hipotezat e ngritura në këtë studim trajtohen më shumë në kuadër të kreut të metodologjisë, por ato mund të rradhohen si:

H₁₀ – Menaxherët kanë bërë vlerësimin e gjendjes dhe performancës financiare në vendimmarrje gjatë periudhës 2012-2016.

H_{1a} – Menaxherët nuk kanë bërë vlerësimin e gjendjes dhe performancës financiare në vendimmarrje gjatë periudhës 2012-2016.

H₂₀ – Investimi afatgjatë – themelimi i supermarketit “Prima Center” ka përmirësuar gjendjen dhe performancën financiare të firmës “Molika Vigjilent, sh.p.k.” Tetovë.

H_{2a} – Investimi afatgjatë – themelimi i supermarketit “Prima Center” ka përkeqësuar gjendjen dhe performancën financiare të firmës “Molika Vigjilent, sh.p.k.” Tetovë.

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Meqenëse në kërret pasues dhe sidomos që lidhet me metodologjinë dhe të dhënat do të diskutohet më gjerësisht për këtë problematikë, këtu në terma të përgjithshëm prezantohet metodologjia e hulumtimit.

Kuptohet, dy metodat shkencore të përdorura zakonisht nga studiuesit janë metodat kualitative dhe kuantitative.

Andaj, në pjesën empirike të kësaj teze do të përdoren metodat shkencore kualitative dhe kuantitative.

Fillimisht të dhënat primare kontabël që lidhen me gjendjen dhe performancën financiare të firmës “Molika Vigjilent, sh.p.k.” Tetovë gjatë periudhës 2012-2016 do të merren dhe analizohen duke përdorur një sërë teknika dhe analiza të fushës së pasqyrave financiare.

Të dhënat primare përfshijnë bilancin e gjendjes dhe pasqyrën e të ardhurave apo bilancin e suksesit dhe raportet tjera kontabël-financiarë për vitin 2012, 2013, 2014, 2015 dhe 2016. Këto të dhëna nuk janë përdorur më herët në një studim si ky andaj paraqesin të dhëna bazë. Por, më tej do të shfrytëzohen edhe të dhëna të tjera jo vetëm nga pasqyrat financiare, pra jo vetëm me karakter kontabël-financiar.

STRUKTURIMI I PUNIMIT

ABSTRAKTI.....	8
ABSTRACT.....	9
ABSTRAKT	10
1. HYRJE.....	11
1.1. Rëndësia e studimit	11
1.2. Objektivat e studimit	12
1.3. Definimi i problemit.....	12
2. RISHIKIMI I LITERATURËS	14
2.1. Pasqyrat financiare, disa koncepte teorike	14
2.2. Roli i analizës së pasqyrave financiare në vendimmarrjen afariste.....	27
2.3. Informacioni kontabël dhe përdoruesit	28
2.4. Studimet paraprake dhe evidenca empirike	29
3. TË DHËNAT DHE METODOLOGJIA E HULUMTIMIT.....	31
3.1. Burimet e të dhënave	31
3.2. Rasti i studimit.....	32
3.3. Hipotezat	33
3.4. Metodologjia e hulumtimit.....	33
4. ANALIZA DHE DISKUTIMI I REZULTATEVE.....	34
4.1. Analiza horizontale	35

4.2. Analiza vertikale	44
4.3. Analiza e trendit.....	47
4.4. Treguesit financiarë	50
4.5. Analiza krahasimore e treguesve financiar, para dhe pas investimit në “Prima Center” ...	53
4.6. Analiza me skenarë – Informatat relevante.....	54
4.7. Informacioni kontabël në funksion të vendimmarrjes – gjetjet nga analiza cilësore/sasiore	57
4.8. Përmbledhje dhe diskutimi i rezultateve	61
5. PËRFUNDIME, REKOMANDIME DHE KUFIZIMET E STUDIMIT	67
5.1. Përfundime në kontekst të rastit studimor.....	67
5.2. Rekomandime në kontekst të rastit studimor	68
5.3. Rekomandime për studim të mëtejshëm	68
5.4. Kufizimet e studimit	69
BIBLIOGRAFIA	70

LISTA E TABELAVE

Tabela 1 Bilanci i gjendjes	36
Tabela 2 Rritja dhe zvogëlimi i zërave të Bilancit të gjendjes	39
Tabela 3 Bilanci i suksesit	39
Tabela 4 Rritja dhe zvogëlimi i zërave në Bilancin e suksesit	41
Tabela 5 Analiza vertikale-Bilanci i gjendjes.....	43
Tabela 6 Analiza vertikale-Bilanci i suksesit	44
Tabela 7 Analiza e trendit-Bilanci i gjendjes	46
Tabela 8 Analiza e trendit- Bilanci i suksesit	47
Tabela 9 Treguesit Financiarë	49
Tabela 10 Performanca para dhe pas investimit.....	55
Tabela 11 Përmbledhja e rezultateve nga pyetësi.....	60

LISTA E FIGURAVE

Grafikoni 1 Aktivitet e bilancit të gjendjes	37
Grafikoni 2 Pasiva e bilancit të gjendjes	Error! Bookmark not defined.
Grafikoni 3 Rritja dhe zvogëlimi i zërave të Bilancit të gjendjes - Aktiva.....	38
Grafikoni 4 Rritja dhe zvogëlimi i zërave të Bilancit të gjendjes - Pasiva ..	Error! Bookmark not defined.
Grafikoni 5 Bilanci i Suksesit.....	40
Grafikoni 6 Rritja dhe zvogëlimi i zërave në Bilancin e suksesit.....	42
Grafikoni 7 Analiza vertikale-Bilanci i gjendjes	44
Grafikoni 8 Analiza vertikale-Bilanci i suksesit.....	45
Grafikoni 9 Analiza vertikale - Bilanci i suksesit(vazhdon).....	45
Grafikoni 10 Analiza e trendit- Bilanci i gjendjes	47
Grafikoni 11 Analiza e trendit- Bilanci i suksesit.....	48
Grafikoni 12 Raportet e aktivitetit	49
Grafikoni 13 Raportet e likuiditetit.....	50
Grafikoni 14 Treguesit e aftësisë paguese.....	50
Grafikoni 15 Raporti borxh/kapital.....	50
Grafikoni 16 Raportet e përfitueshmërisë	51
Grafikoni 17 ROA dhe ROE	52
Grafikoni 18 Shpenzimet për lëndën e parë	

ABSTRAKTI

Ky punim masteri trajton vlerësimin e gjendjes dhe performancës financiare nga perspektiva e vendimmarrjes menaxheriale. Për analizë është përzgjedhur firma “Molika Vigjilent, sh.p.k.” Tetovë për periudhën 2012-2016”. Studimi tregon se përgjithësisht ka dallime nga perspektiva e periudhës para dhe pas investimit afatgjatë të realizuar nga kompania. Studimi sugjeron më tej që menaxherët e firmës të përdorin ende më shumë dhe më shpesh informacionin financiar në vendimmarrjen biznesore. Menaxherët përgjithësisht kanë bërë vlerësimin e gjendjes dhe performancës financiare në vendimmarrje gjatë periudhës 2012-2016.

Duke përdorur një metodologji të mirënjohur dhe caktuar në fushën e analizës së pasqyrave financiare dhe analizën sasiore të të dhënave kontabël u dëshmuua se viti 2014 ka qenë vitë kritik për subjektin e analizuar në kuadër të këtij punimi masteri. Mbase me variacione të caktuara në kuadër të bilancit të gjendjes por gjithsesi që efekti është mjaft i theksuar dhe i dukshëm në bilancin e suksesit (ROA ulet me 73% dhe ROE me 72%). Pikërisht në këtë vit kompania realizon investimin afatgjatë dhe i cili ka gjeneruar efekte pozitive në funksion të përmirësimit të treguesve financiarë. Rezultatet tregojnë përgjithësisht një përmirësim dhe sidomos në bilancin e suksesit, madje në dy treguesit kryesor financiarë menjëherë një vit pas (2015), për shembull, ROA rritet me 52% dhe ROE rritet me 46%.

ABSTRACT

This master thesis deals with the evaluation of financial position and performance from the perspective of managerial decision-making. The firm "Molika Vigjilent, l.l.c." Tetovo has been selected for analysis for the period 2012-2016". The study shows that there are generally differences from the perspective of the period before and after the long-term investment made by the firm. The study further suggests that firm managers should use financial information even more and more often in business decision-making. Managers have generally assessed the financial position and performance in decision making during the period 2012-2016.

Using a well-known and determined methodology in the field of financial statements analysis and quantitative analysis of accounting data, it was proved that 2014 has been a critical year for the subject analyzed in this master thesis. Maybe with certain variations within the balance sheet but still the effect is quite pronounced and visible in the income statement (ROA decreases by 73% and ROE by 72%). Exactly in this year the company realizes the long-term investment and which has generated positive effects in order to improve the financial ratios. The results generally show an improvement and especially in the income statement, even in the two main financial indicators immediately one year after (2015), for example, ROA increases by 52% and ROE increases by 46%.

АБСТРАКТ

Овој магистерски труд ја третира проценката на финансиската состојба и перформансот од перспектива на менаџерско донесување одлуки. Компанијата „Молика Виџилент и др.“ Доел Тетово е избрана за анализа за периодот 2012-2016 година. Студијата покажува дека генерално има разлики од перспектива на периодот пред и по долгорочната инвестиција направена од компанијата. Студијата понатаму сугерира дека менаџерите на фирмите уште почесто треба да користат финансиски информации при донесување на деловни одлуки.

Користејќи добро позната и дефинирана методологија во областа на анализа на финансиски извештаи и квантитативна анализа на сметководствени податоци, се докажа дека 2014 година е критична година за предметот анализиран во рамките на оваа магистерска теза. Можеби со одредени варијации во рамките на билансот на состојба, но сепак ефектот е доста изразен и видлив во билансот на успех (ROA кој се намалува за 73% и ROE за 72%). Токму во оваа година компанијата ја реализира долгорочната инвестиција и која генерираше позитивни ефекти со цел да ги подобри финансиските индикатори. Резултатите генерално покажуваат подобрување и особено во билансот на успех, дури и кај двата главни финансиски показатели непосредно после една година (2015 година), на пример, ROA се зголемува за 52% и ROE се зголемува за 46%.

1. HYRJE

Si menaxher, ju do të kishit dashur që t'i shpërbleni punëtorët tuaj bazuar në performancën e tyre. Por nga mund ta dish sesa mirë kanë punuar? Si mund ta kuptosh se cili repart apo filial ka performuar më mirë? Si huadhënës, nga do ta dish se huamarrësi do të kthejë borxhin ashtu si ka premtuar? Si menaxher i një ndërmarrje, si do ta dish se kapaciteti ekzistues nuk është i mjaftueshëm dhe duhet të zgjerohet apo shtohet? Si një investitor, si do të mund të parashikosh se aksionet e cilës ndërmarrje t'i blesh që të kesh fitim më të lartë? Si mund të vëresh se një aksion është me risk më të lartë/ulët se tjetri? Këto dhe disa pyetje të tjera të zakonshme mund të gjejnëpërgjigje nëpërmjet analizës financiare si instrument i rëndësishëm nëvendimmarrjenafariste.

Analiza financiare e ndihmon procesin e vendimmarrjes financiare. Vendimmarrja financiare përfshin analizimin e problemeve financiare me të cilat përballet ndërmarrja dhe vendos se çfarë veprime apo aksione duhet të ndërmerren në funksion të zgjidhjeve të tyre.

Më tej, analiza financiare i referohet një vlerësimi të qëndrueshmërisë, stabilitetit dhe profitabilitetit të një biznesi ose projekti. Zakonisht realizohet nga profesionist të cilët përgatitin raportet-pasqyrat duke përdorur një sërë teknika dhe metoda. Këto raporte përdoren nga menaxhmenti i kompanisë si bazë për marrjen e vendimeve të ndryshme në cilësinë e përdoruesit të brendshëm, por edhe nga mjaft përdorues të tjerë brenda dhe jashtë biznesit.

Analiza e pasqyrave financiare definohej si proces i identifikimit të fuqisë dhe dobësisë financiare të një kompanie duke vendosur mirë lidhjen në mes pasqyrave financiare të ndryshme që përgatit kompania. (RAPPAPORT, 1974)¹

1.1. Rëndësia e studimit

Vlerësimi i gjendjes dhe performancës financiare i njohur dhe inkorporuar shpesh në nocionin “Analiza e pasqyrave financiare” është një sistem për procesimin e informatave, i dizajnuar për të furnizuar me të dhëna vendimmarrësit duke deshifruar informacionet nga raportet financiare (XHAF, 2008)². Teknika të ndryshme përdoren për të analizuar pasqyrat financiare për të theksuar rëndësinë krahasuese dhe lidhëse të informatave të prezantuara si dhe për të vlerësuar pozitën e kompanisë.

Treguesit financiarë janë mjete që i mundësojnë menaxhmentit apo përdoruesve të tjerëpër të analizuar situatën-gjendjen e biznesit si dhe për të vëzhguar performancën e kompanisë.

Teknika të ndryshme përdoren për të analizuar pasqyrat financiare dhe kështu për të vlerësuar gjendjen dhe performancën financiare të biznesit. Më tej, treguesit financiarë janë mjete që i mundësojnë menaxhmentit apo vendimmarrësve në përgjithësi për të analizuar biznesin, performancën dhe gjendjen e kaluar, të tashme si dhe në funksion të projeksioneve tëardhshme.

¹RAPPAPORT, Alfred, “Financial Statement Analysis”, 1974 Englewood Cliffs, New Jersey, Prentice Hall, f. 62.

²XHAF, Prof. Dr. Halit, “Analiza e Pasqyrave Financiare”, Tiranë, 2008, fq. 5.

Rëndësia e analizës financiare në procesin e investimit është e pazëvendësueshme dhe investorët mundohen që të parashikojnë rrjedhjet e ardhshme të parave si dhe të vlerësojnë profitabilitetin e investimeve. Si rrjedhojë, ky moment nuk paraqet vetëm një objekt hulumtues dhe me karakter shkencor, por ka edhe rëndësinëpraktike dhe menaxheriale.

Andaj, mendojmë se ky punim do të trajton edhe pikëpamjen teorike edhe atë praktike, në disa terma të përgjithshëm disa prej tyre mund të jenë: njohja me vlerësimin e gjendjes dhe performancës financiare nga perspektiva menaxheriale; cilët janë anët e dobëta dhe të forta të firmës kundrejt më shumë krahasimeve; sa është i njohur menaxhmenti i biznesit si përdorues i brendshëm i informacionit kontabël me pasqyrat financiare; dhe ç'farë duhet bërë më tej që të rritet interesi i menaxhmentit të biznesit në rëndësinë dhe peshën që ka analiza e pasqyrave financiare në vendimmarrjen afariste; etj.

1.2. Objektivat e studimit

Në këtë punim do të analizojmë sa dhe si informacioni kontabël shfrytëzohet në vendimmarrjen afariste, konkretisht në rastin e firmës të zgjedhur në këtë studim, pra “Molika Vigjilent, sh.p.k.” Tetovë. Me fjalë të tjera, studimi ka për qëllim të nxjerrë në sipërfaqe nëse informacioni kontabël si instrument ka ndihmuar, në ç'masë dhe si, vendimmarrjen afariste, konkretisht të menaxherëve. Informacioni i tillë kontabël dhe financiar derivohet nga vlerësimi i gjendjes dhe performancës së biznesit.

Të dhënat e përzgjedhura për periudhën në fjalë do të analizohen dhe përmes teknikave dhe metodologjisë së caktuar do të arrihet në disa përfundime të caktuara. Do të analizojmë periudhën para dhe pas investimit për të pasur më të qartë ndryshimet në pasqyrat financiare, respektivisht në gjendjen dhe performancën e përgjithshme të firmës, që nënkupton përkeqësimet apo përmirësimet e mundshme të cilat kanë ndodhur në këtë periudhë.

E gjithë kjo, përmirësimi apo përkeqësimi do të analizohet në funksion të asaj nëse menaxherët e firmës kanë bërë vlerësimin e gjendjes dhe performancës financiare, apo vendimet janë marrë mbi bazën rutine apo të përvojës.

Njëkohësisht, ky studim pretendon të ndihmon edhe vendimmarrjen menaxheriale duke nxjerr disa rekomandime tëmundshme sesi të përmirësohet gjendja dhe performanca e ardhshme e biznesit në fjalë, në terma të treguesve financiarë, por edhe të aktivitetit të gjithëmbarshtëm afarist.

1.3. Definimi i problemit

Analiza financiare mund të jetë e brendshme për të vlerësuar çështje sikurse është performanca e punëtorëve, efikasiteti dhe efektiviteti i funksioneve apo operacioneve të ndërmarrjes si dhe politikën e kreditit, dhe e jashtme për të vlerësuar investimet potenciale si dhe aftësinë kreditore të huamarrësve tanë. (XHAFa, 2008)³

³XHAFa, Prof. Dr. Halit, “Analiza e Pasqyrave Financiare”, Tiranë, 2008, fq. 125.

Bazuar në definimin e mësipërm, do të mundohemi tështrojmë problemin konkret që lidhet me biznesin e qëështë objekt studimi në kuadër të këtij punimi – firma “Molika Vigjilent, sh.p.k.” Tetovë.

Mbështetur dhe duke përdorur të dhënat kontabël të kësaj firme për periudhën 2012 – 2016 do të përpiqemi që të nxirren disa rezultate konkrete sipas periudhës para dhe pas investimit.

Investimi është bërë në vitin 2014 me themelimin e supermarketit “Prima Center” Dooel Tetovë dhe është me interes të dihet ndikimi përkatës në performancën financiare të dy ndërmarrjeve dhe sa i leverdishëm ka rezultuar ky investim i bërë nga firma “Molika Vigjilent, sh.p.k.” Tetovë.

Me qëllim që lexuesi të ketë kuptimin më përmbajtësor të rezultateve por edhe rekomandimeve në fund të punimi, gjykojmë që fillimisht tëprezantojmë një pasqyrë tëpërgjithshme të këtij biznesi dhe përshkruajmë në vija tëpërgjithshme aktivitetin afarist që firma e realizon.

Firma “Molika Vigjilent, sh.p.k.” Tetovë është ndërmarrje private që merret me prodhimin si dhe eksport-importin e mobileve, në veçanti dhomave të gjumit. Është themeluar më 26.07.1990.

Në vitin 2010 ajo bleu shumicën e aksioneve të shoqërisë aksionare “Industriski Ladilnik” dhe u bë aksionarja kryesore me një përqindje të lartë të aksioneve duke e marrë të drejtën e udhëheqjes mbi këtë ndërmarrje, ndërsa në vitin 2014 themeloi edhe supermarketin “Prima Center”.

Supermarketi “Prima Center” është themeluar me datën 21.10.2014 nga ana e ndërmarrjes “Molika Vigjilent, sh.p.k.” Tetovë. Veprimtaria e këtij supermarketi është shitblerja e artikujve të konsumit të gjerë si dhe në kuadër të tij funksionon edhe restoranti me po të njëjtin emër.

2. RISHIKIMI I LITERATURËS

2.1. Pasqyrat financiare, disa koncepte teorike

Pasqyrat financiare përshkruajnë shëndetin financiar të kompanisë. “Qëllimi i pasqyrave financiare është dhënia e informacioneve për pozitën financiare, performancën financiare dhe ndryshimet në pozitën financiare të një kompanie”⁴. Pasqyrat financiare duhet të jenë të kuptueshme, të përshtatshme, të besueshme dhe të krahasueshme. Ato japin një pasqyrë të saktë të kushteve dhe rezultatit operativ të kompanisë në një formë të kondensuar. Analizimi dhe interpretimi i pasqyrave financiare ndihmon në përcaktimin e pozitës së likuiditetit, aftësisë paguese afatgjate, qëndrueshmërisë financiare, profitabilitetin dhe qëndrueshmërinë e një kompanie. Ekzistojnë katër lloje themelore të pasqyrave financiare: (1) bilanci i gjendjes, (2) pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve (bilanci i suksesit), (3) pasqyra e rrjedhjes së parasë – cash flow dhe (4) pasqyra e fitimit të pashpërndarë. Gjithashtu disa kompani përpilojnë edhe pasqyrën për strukturën e kapitalit të vet si dhe çdo kompani ka shënimet plotësuese (XHAFa, 2008)⁵.

Pasqyra e të ardhurave tregon rezultatin neto të aktivitetit të biznesit gjatë një periudhe kontabël, kurse bilanci i gjendjes tregon pozicionin përfundimtar të ndërmarrjes afariste në një datë të caktuar. Pra, mund të themi se hapi i fundit i ciklit të kontabilitetit është përgatitja e pasqyrave financiare dhe se ky cikël mbaron me përpilimin e bilancit të gjendjes.

Pasqyrat financiare dhe më konkretisht bilanci i suksesit kërkohen të konstatojnë nëse ndërmarrja po realizon fitim adekuat dhe të dijë nëse fitimet janë rritur ose zvogëluar në krahasim me vitin e kaluar, në mënyrë që hapat korrigjues të mund të merren edhe më parë.

Pasqyrat financiare ndihmojnë në analizimin e pozitës së biznesit në lidhje me kapacitetin e njësisë ekonomike për të shlyer detyrimet e saj të shkurtra dhe afatgjata (perspektiva nga bilanci i gjendjes).

Përmes krahasimit të të dhënave të dy apo më shumë viteve të biznesit, ne mund të nxjerrim një përfundim kuptimplotë sa i përket rritjes së biznesit. Për shembull, rritja e shitjeve me rritjen e njëkohshme të fitimeve të biznesit, tregon një shenjë të shëndoshë për rritjen e biznesit.

Pasqyrat financiare ndihmojnë njësinë ekonomike dhe pretendentët e sajë në përcaktimin e aftësisë paguese të biznesit dhe ndihmon për t'u përgjigjur në aspekte të ndryshme, d.m.th. nëse është e aftë të blejë aktive nga burimet e veta dhe/ose nëse njësia ekonomike mund të paguajë detyrimet e saj në kohë.

⁴ The framework for the preparation and presentation of financial statements (Korniza për përpilimin dhe prezantimin e raporteve financiare) – International Accounting Standards Board (IASB). https://library.croner.co.uk/cch_uk/iast/miscframework-198907.

⁵XHAFa, Prof. Dr. Halit, “Analiza e Pasqyrave Financiare”, Tiranë, 2008, fq. 115.

Për të bërë një studim krahasues mbi rentabilitetin e njësisë ekonomike me subjektet e tjera të angazhuara në të njëjtën tregti ose degë afariste, pasqyrat financiare i ndihmojnë menaxhmentit të miratojë një politikë të shëndoshë të biznesit duke bërë krahasime nga më tëndryshme duke përdorur një sërë teknika dhe metoda të mirënjohura në fushës e analizës së pasqyrave financiare.

Më tej, pasqyrat financiare ndihmojnë menaxhmentin e biznesit të bëjë parashikime dhe të përgatisë buxhetet duke ofruar kështu informacion në lidhje me pikat e dobëta të biznesit në mënyrë që të mund të marrë masa korrigjuese.

Pasqyrat financiare përgatiten nga entitetet për të komunikuar me palë të ndryshme për pozicionin e tyre financiar, dhe performancën ekonomike dhe financiare. Prandaj, mund të përfundohet se të kuptuarit e pasqyrave financiare bazë është një hap i nevojshëm drejt menaxhimit të suksesshëm të një biznesi.

Obligimi për përpilimin e pasqyrave financiare kërkohet me ligj dhe në këtë rast flasim për kërkesat e kontabilitetit financiarë. Entiteti kontabël ka për obligim të përpilojë pasqyrat financiare në fund të vitit financiar, pra për një periudhë 1 vjeçare. Për qëllime të brendshme të raportimit, pasqyrat financiare të kompanisë mund të përpilohen edhe në baza mujore, tre mujore, gjashtë mujore si dhe vjetore, dhe në këtë rast flasim për perspektivën e kontabilitetit menaxherial.

Bilanci i gjendjes

Pasqyra e pozitës financiare, e njohur edhe si bilanci i gjendjes, paraqet pozicionin financiar të një njësie ekonomike në një datë të caktuar. Ai përbëhet nga tre komponentë kryesore: Asetet, detyrimet dhe kapitali (XHAFa, 2005)⁶.

Pasqyra e pozicionit financiar ndihmon përdoruesit e pasqyrave financiare për të vlerësuar qëndrueshmërinë financiare të një njësie ekonomike në drejtim të rrezikut të likuiditetit, rrezikut financiar, rrezikut të kredisë dhe rrezikut të biznesit (XHAFa, 2005)⁷.

Qëllimi i bilancit të gjendjes është të raportojë pozitën financiare të një kompanie në një kohë të caktuar apo më konkretisht në një datë të caktuar dhe me të drejtë shpesh quhet fotografi çasti. Në bilancin e gjendjes, vetë kompania dhe jo pronarët e saj shihen si zotëruesit e të gjitha burimeve që përdorin dhe të gjitha borxheve që kanë. Në bilancin e gjendjes gjithashtu duhet të potencohet edhe periudha kohore e raportit financiar.

Bilanci i gjendjes është si një fotografi financiare që tregon pozicionin financiar të kompanisë në një pikë të caktuar, pra në një datë të caktuar, zakonisht në 31.12.20XX.

Sipas XHAFa (2005) bilanci i gjendjes përbëhet nga elementët kryesorë si në vijim⁸.

Asetet/Mjetet - Një aktiv është diçka që një njësi ekonomike zotëron ose kontrollon për të nxjerrë përfitime ekonomike nga përdorimi i saj. Më tej, mjetet klasifikohen në pasqyrën e pozicionit financiar në bazë të natyrës së tyre, krahas klasifikimeve të tjera, si:

⁶XHAFa, Prof.Dr.Halit, "Drejtimi Financiar", Tiranë, 2005, fq.85.

⁷XHAFa, Prof. Dr. Halit, "Drejtimi Financiar", Tiranë, 2005, fq. 85.

⁸XHAFa, Prof. Dr. Halit, "Drejtimi Financiar", Tiranë, 2005, fq. 92.

Aktivitet fikse janë mjete afatgjate të prekshme që janë në pronësi të kompanisë dhe po të njëjtat i përdor në gjenerimin e të ardhurave të saj (MTETWA, 2010)⁹.

Aktivitet qarkulluese janë ato aktive të kompanisë të cilat ndryshe nga aktivitet fikse janë të konvertueshme në mjete monetare në një periudhë më të shkurtër se një vit. Ato janë më likuide dhe janë në qarkullim të vazhdueshëm pasi që përdoren për të realizuar operacionet e biznesit, operacione që janë në vazhdimësi e sipër në varësi të procesit të prodhimit (MTETWA, 2010)¹⁰.

Detyrimet - Një detyrim është borxh që një biznes i detyrohet dikujt dhe zgjidhja (pagesa) e tij përfshin transferimin e parave ose burimeve të tjera. Detyrimet duhet të klasifikohen në pasqyrën e pozicionit financiar si të tanishëm ose afatgjatë varësisht nga kohëzgjatja në të cilën njësia ekonomike synon të shlyejë detyrimin (MTETWA, 2010)¹¹. Më tej, detyrimet krahas klasifikimit afatshkurtër ose afatgjatë, gjithashtu klasifikohen në pasqyrën e pozicionit financiar në bazë të natyrës së tyre (MTETWA, 2010)¹² si vijon:

Pagesat e tregtisë dhe të tjera përfshijnë kryesisht detyrimet për furnizuesit dhe kontraktorët për blerje kredie.

Huat afatshkurtra zakonisht përfshijnë mbitërheqjet bankare dhe huat bankare afatshkurtra me një afat shlyerjeje më të shkurtër se 12 muaj.

Huat afatgjata përbëhen nga kreditë të cilat duhet të shlyhen gjatë një periudhe që tejkalon një vit.

Tatimi aktual i pagueshëm zakonisht paraqitet si një zë i veçantë në pasqyrën e pozicionit financiar për shkak të materialitetit të shumës.

Kapitali - Kapitali është ajo që biznesi u detyrohet pronarëve të saj. Kapitali rrjedh duke zbritur totalin e detyrimeve nga totali i aktiveve dhe prandaj përfaqëson interesin e mbetur që i përket pronarëve (aksionarëve). Kapitali zakonisht paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar sipas kategorive të mëposhtme (MTETWA, 2010)¹³:

- Kapitali aksionar përfaqëson shumën e investuar nga pronarët në njësinë ekonomike.
- Fitimi i mbartur përbëhet nga fitimi ose humbja neto e mbetur në biznes pas shpërndarjes së pronarëve në formën e dividendëve.
- Rezerva e rivlerësimit përmban suficitin neto të çdo rivlerësimi në rritje të aktiveve afatgjata materiale, të njohura drejtpërdrejt në kapitalin neto.

Kapitali i vet shprehet me barazimin:

$$K (\text{kapitali i vet}) = A (\text{aktivet}) - D (\text{detyrimet})$$

dhe nëse K është negative atëherë firma teknikisht falimenton (MTETWA, 2010)¹⁴.

Bilanci i gjendjes është i strukturuar në atë mënyrë që totali i aktiveve të një njësie të barazohet me shumën e detyrimeve dhe kapitalit.

⁹MTETWA, Munya, "Fixed Assets: Capital Expenditure", 2010, fq. 210.

¹⁰MTETWA, Munya, "Fixed Assets: Capital Expenditure", 2010, fq. 211.

¹¹MTETWA, Munya, "Fixed Assets: Capital Expenditure", 2010, fq. 215.

¹²MTETWA, Munya, "Fixed Assets: Capital Expenditure", 2010, fq. 218.

¹³MTETWA, Munya, "Fixed Assets: Capital Expenditure", 2010, fq. 52.

¹⁴MTETWA, Munya, "Fixed Assets: Capital Expenditure", 2010, fq. 50.

Bilanci i suksesit/Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

Pasqyra e të ardhurave përgatitet në bazë të përlogaritjeve të kontabilitetit. Kjo do të thotë se të ardhurat njihen kur fitohen më tepër sesa kur realizohen faturat (CLAUSEN, 2009)¹⁵.

Në anën tjetër, shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave kur ato lindin, edhe nëse ato paguhen në periudhat e mëparshme ose pasuese të kontabilitetit. Pasqyra tradicionale e të ardhura regjistron vetëm transaksionet dhe jo mundësitë. Sikurse që kanë thënë Block, Hirt dhe Short: “Ekonomisti definon të hyrat si dallime në vlerën reale që ndodhin mes fillimit dhe fundit të një periudhe të caktuar. Për ekonomistin, një rritje në vlerën e tokës së kompanisë si rezultat i një aeroporti që ndërtohet në një pronë aty afër paraqet një rritje në vlerën reale të kompanisë. E cila pastaj përfaqëson një të hyrë. Kontabilisti nuk e zbaton një definicion aq të gjerë dhe të thellë për të hyrat”. (Stanley Block, Geoffrey Hirt, Doug Short, 1998)¹⁶

Sipas CLAUSEN (2009) pasqyra e të ardhurave përbëhet nga elementët kryesorë si në vijim¹⁷:

Të ardhurat - Të ardhurat përfshijnë të ardhurat e fituara nga aktivitetet kryesore të një njësie ekonomike (CLAUSEN, 2009)¹⁸. Kështu, për shembull, në rastin e një prodhuesi të pajisjeve elektronike, të ardhurat do të përbëhen nga shitjet e pajisjeve elektronike.

Kostoja e shitjeve - Kostoja e shitjeve përfaqëson koston e mallrave të shitura ose shërbimeve të kryera gjatë një periudhe kontabël (CLAUSEN, 2009)¹⁹. Prandaj, për një shitës me pakicë, kostoja e shitjeve do të jetë shuma e inventarit në fillim të periudhës dhe blerjet gjatë periudhës minus inventari në fund.

Të ardhura të tjera - Të ardhurat e tjera përbëhen nga të ardhurat e fituara nga aktivitetet që nuk janë të lidhura me biznesin kryesor të njësisë ekonomike-firmës. Për shembull, të ardhurat e tjera të një njësie ekonomike që prodhon pajisje elektronike mund të përfshijnë (CLAUSEN, 2009)²⁰:

- Fitimi në dispozicion të aseteve fikse,
- Të ardhura nga interesi në depozita bankare,
- Fitimi i këmbimit në përkthimin e një llogarie bankare në valutë të huaj.

¹⁵ CLAUSEN, James, “Accounting 101 - Income Statement: Financial Reporting and Analysis of Profit and Loss”, 2009, fq. 102.

¹⁶ Stanley Block, Geoffrey Hirt, Doug Short, “Foundations of Financial Management”, botimi 8, 1998, fq. 34.

¹⁷ CLAUSEN, James, “Accounting 101 - Income Statement: Financial Reporting and Analysis of Profit and Loss”, 2009, fq. 107.

¹⁸ CLAUSEN, James, “Accounting 101 - Income Statement: Financial Reporting and Analysis of Profit and Loss”, 2009, fq. 103.

¹⁹ CLAUSEN, James, “Accounting 101 - Income Statement: Financial Reporting and Analysis of Profit and Loss”, 2009, fq. 104.

²⁰ CLAUSEN, James, “Accounting 101 - Income Statement: Financial Reporting and Analysis of Profit and Loss”, 2009, fq. 107.

Kostoja e shpërndarjes - Kostoja e shpërndarjes përfshin shpenzimet e bëra për dërgimin e mallrave nga lokalet afariste tek konsumatorët.

Shpenzimet administrative - Shpenzimet administrative në përgjithësi përfshijnë shpenzimet që lidhen me funksionet e menaxhimit dhe mbështetjes brenda një organizate që nuk janë drejtpërdrejt të përfshirë në prodhimin dhe furnizimin e mallrave dhe shërbimeve të ofruara nga njësia. Shembuj të shpenzimeve administrative përfshijnë (CLAUSEN, 2009)²¹:

- Kostoja e pagës së menaxhimit ekzekutiv,
- Pagesat ligjore dhe profesionale,
- Zhvlerësimi i ndërtesës së zyrave qendrore,
- Shpenzimet e qirasë të zyrave të përdorura për qëllime administrimi dhe menaxhimi,
- Kostoja e funksioneve / departamenteve që nuk janë drejtpërdrejt të përfshira në prodhim si departamenti i financave, departamenti i resurseve humane (HR) dhe departamenti i administratës,
- Shpenzime të tjera. Kjo është në thelb një kategori e mbetur në të cilën përfshihen shpenzimet që nuk janë të klasifikueshme në mënyrë të përshtatshme diku tjetër.

Pagesat e financave - Pagesat financiare zakonisht përbëhen nga shpenzimet e interesit për huat dhe borxhet.

Tatimi në të ardhura - Shpenzimet e tatimit mbi fitimin të njohur gjatë një periudhe përgjithësisht përbëhen nga tre elementet e mëposhtme (CLAUSEN, 2009)²²:

- Tarifa e parashikuar tatimore e periudhës aktuale,
- Rregullimet e taksave paraprake dhe
- Shpenzimet e shtyra tatimore.

Në fund të kësaj pjesë duhet potencuar edhe krahasimi i informacionit, respektivisht informacioni financiar i periudhës së mëparshme duhet të paraqitet bashkë me informacionin e periudhës ose datës aktuale për të lehtësuar krahasimin e performancës ose gjendjes financiare të subjektit ekonomik.

Prandaj është e rëndësishme që shifrat krahasuese të periudhës paraardhëse, të paraqitura në pasqyrën e të ardhurave ose bilancin e gjendjes ose ndonjë raport tjetër financiarë, të lidhen me një periudhë ose datë të ngjashme. Për shembull, nëse një subjekt po përgatit bilancin e suksesit për gjashtë muajt e fundit që përfundon më 31 dhjetor 2020, shifrat krahasuese të periudhës së mëparshme duhet të lidhen me gjashtë muajt e mbyllur më 31 dhjetor 2019.

Pasqyra e flukseve të parave - Cash flow

Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare, e njohur edhe si pasqyra e rrjedhës së parasë, paraqet lëvizjen në flukset e mjeteve monetare gjatë periudhës kontabël dhe si e tillë klasifikohet në: aktivitetet operative, investuese dhe financuese (XHAFSA, 2008)²³.

²¹CLAUSEN, James, "Accounting 101 - Income Statement: Financial Reporting and Analysis of Profit and Loss", 2009, fq. 110.

²²CLAUSEN, James, "Accounting 101 - Income Statement: Financial Reporting and Analysis of Profit and Loss", 2009, fq. 112.

²³ XHAFSA, Prof. Dr. Halit, "Analiza e Pasqyrave Financiare", Tiranë, 2008, fq. 85.

Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare paraqet lëvizjen në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare gjatë njëperiudhe kontabël. Paraja dhe ekuivalentët e saj në përgjithësi përbëhen nga sa më poshtë (XHAFa, 2008)²⁴:

- Para në dorë,
- Paratë në bankë,
- Investimet afatshkurtra që janë shumë likuide dhe përfshijnë rrezik shumë të ulët të ndryshimit në vlerë (prandaj zakonisht përjashtohen investimet në instrumentet e kapitalit neto).

Të gjitha flukset e mjeteve monetare klasifikohen nën aktivitetet operative, investuese dhe financuese siç diskutohet më poshtë.

Aktivitetet operative - Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative paraqet lëvizjen në mjete monetare gjatë një periudhe kontabël nga aktivitetet primare të gjenerimit të të ardhurave të njësisë ekonomike (XHAFa, 2008)²⁵. Për shembull, aktivitetet operative të një hoteli do të përfshijnë hyrjet dhe daljet në para nga biznesi i hotelit (p.sh. faturat nga të ardhurat e shitjeve, pagat e paguara gjatë vitit etj), por të ardhurat nga interesi në një depozitë bankare nuk do të klasifikohen si të tilla (të ardhurat nga interesi do të paraqiten në aktivitetet investuese). Fitimi para tatimit siç paraqitet në pasqyrën e të ardhurave mund të përdoret si pikë fillestare për të llogaritur flukset e mjeteve monetare nga aktivitetet operative. Pas rregullimeve kërkohet që të bëhen në fitim para tatimit për të arritur në rrjedhën e parasë nga operacionet (XHAFa, 2008)²⁶ si vijon:

- Eliminimi i shpenzimeve, jo të holla (p.sh. amortizimi, humbjet nga zhvlerësimi, borxhet e këqija të shlyera, etj),
- Largimi i shpenzimeve që do të klasifikohen diku tjetër në pasqyrën e rrjedhës së parasë (p.sh. shpenzimet e interesit duhet të klasifikohen nën aktivitetet e financimit),
- Eliminimi i të ardhurave jo të holla (p.sh. fitimi për rivlerësimin e investimeve),
- Heqja e të ardhurave që do të prezantohen diku tjetër në pasqyrën e rrjedhës së parasë (p.sh. të ardhurat e dividendit dhe të ardhurat nga interesi duhet të klasifikohen në aktivitetet investuese përveç në rastin e, për shembull, një banke investimi),
- Ndryshimet e kapitalit të punës (p.sh. një rritje në llogaritë e arkëtueshme tregtare duhet të zbriten për të arritur në të ardhurat e shitjeve që në të vërtetë kanë rezultuar me fluksin e mjeteve monetare gjatë periudhës).

Aktivitetet investuese - Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese përfshin lëvizjen në rrjedhën e parasë si rezultat i blerjes dhe shitjes së asetëve (mjeteve) të ndryshme nga ato të cilat njësisia ekonomike kryesisht tregton (p.sh. inventari). Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese përbëhet kryesisht nga sa vijon (XHAFa, 2008)²⁷:

²⁴XHAFa, Prof. Dr. Halit, "Analiza e Pasqyrave Financiare", Tiranë, 2008, fq. 87.

²⁵XHAFa, Prof. Dr. Halit, "Analiza e Pasqyrave Financiare", Tiranë, 2008, fq. 88.

²⁶XHAFa, Prof. Dr. Halit, "Analiza e Pasqyrave Financiare", Tiranë, 2008, fq. 90.

²⁷XHAFa, Prof. Dr. Halit, "Analiza e Pasqyrave Financiare", Tiranë, 2008, fq. 90.

- Rrjedhja e parave të gatshme që është shpenzuar për blerjen e investimeve dhe aseteve fikse,
- Hyrja në para nga të ardhurat nga investimet,
- Hyrja në para nga disponimi i investimeve dhe aseteve fikse.

Aktivitetet e financimit - Rrjedha e parasë nga aktivitetet e financimit përfshin lëvizjen në rrjedhën e parasë si rezultat i (XHAFa, 2008)²⁸:

- Të ardhurave nga emetimi i kapitalit aksionar, borxheve dhe kredive bankare,
- Dalja e parave të gatshme shpenzuar në koston e financave (d.m.th. dividendët dhe shpenzimet e interesit),
- Rrjedhja e parasë së gatshme mbi riblerjen e kapitalit aksionar dhe shlyerjen e borxheve dhe kredive.

Ashtu siç u cek më herët në pjesën hyrëse të pasqyrave financiare, raporti ose pasqyra e katërt është ajo e fitimit të pashpërndarë. Kuptohet në mes pasqyrave financiare ekziston një lidhje funksionale dhe pasqyrat financiare nuk janë të izoluara njëra prej tjetrës. Ajo që është me interes për tu diskutuar më tej është pikërisht informacioni ose njohja e biznesit duke i lexuar këto pasqyra financiare.

Kjo njohje rezulton duke i ekzaminuar këto bilance me mjaft kujdes dhe duke përdorur një sërë teknika dhe metoda të mirënjohura në fushën e analizës së pasqyrave financiare. Një mjet apo rrugë tradicionale e ekzaminimit të tyre është përdorimi i treguesve apo raporteve financiare dhe një shpjegim/interpretim teorik jepet si vijon.

Kuptohet, gjatë viteve përdoruesit e informacionit kontabël si: investitorët, analistët financiarë, menaxherët, etj. kanë zhvilluar mjete të shumta analitike, koncepte dhe teknika për të krahasuar forcat dhe dobësitë relative të kompanive.

Analiza e raportit është një mjet që është zhvilluar për të kryer analiza sasiore mbi numrat e gjetur në pasqyrat financiare (Horrigam, 1968)²⁹. Raportet ndihmojnë lidhjen e pasqyrave financiare së bashku dhe ofrojnë shifra që janë të krahasueshme midis kompanive dhe industrive dhe sektorëve. Andaj, analiza e raportit është një nga teknikat më të përdorura gjerësisht të analizës së pasqyrave financiare.

Megjithatë, raportet financiare ndryshojnë në industri dhe sektorë të ndryshëm dhe krahasimet ndërmjet llojeve krejtësisht të ndryshme të kompanive shpesh nuk janë të vlefshme ose informacioni nuk i plotë dhe i nuk i shërben siç duhet vendimmarrjes. Përveç kësaj, është e rëndësishme të analizohen trendët në raportet e kompanive, në vend që të theksojnë vetëm shifrat e një periudhe të vetme.

²⁸ XHAFa, Prof. Dr. Halit, "Analiza e Pasqyrave Financiare", Tiranë, 2008, fq. 91.

²⁹ JAMES. O. Horrigam, "A Short History of Financial Ratios Analysis", Accounting Review, 1968, vol. 43, nr. 2, fq. 112.

Raportet ose treguesit financiarë ndahen në disa kategori. Për qëllimet e kësaj analize, raportet e përdorura zakonisht grupohen në katër kategori: aktiviteti, likuiditeti, aftësia paguese dhe rentabiliteti (Horrigam, 1968)³⁰.

Raportet e aktivitetit

Raportet e aktivitetit përdoren për të matur sesa efikase një kompani përdor asetet e saj. Raportet u ofrojnë investitorëve një ide për ecurinë e përgjithshme operationale të një firme.

Raportet e veprimtarisë e matin shkallën në të cilën kompania po kalon pasuritë ose detyrimet e saj. Me fjalë të tjera, ata paraqesin sa herë në vit inventari është rimbushur ose arkëtimet janë mbledhur (Horrigam, 1968)³¹.

Raportet e aktivitetit të përdorura në punim janë:

- (1) raporti i qarkullimit të inventarit,
- (2) raporti i qarkullimit të llogarive të arkëtueshme,
- (3) raporti i qarkullimit të borxhit dhe
- (4) raporti i qarkullimit të mjeteve.

Qarkullimi i inventarit

Qarkullimi i inventarit llogaritet duke pjesëtuar koston e mallrave të shitura me inventarin mesatar (Horrigam, 1968)³². Një qarkullim më i lartë se mesatarja e industrisë do të thotë se inventari shitet me një ritëm më të shpejtë, duke sinjalizuar efektivitetin e menaxhimit të inventarit. Përveç kësaj, një shkallë e qarkullimit të inventarit të lartë do të thotë që më pak burime të kompanisë janë të lidhur në inventar.

Pra, formula e llogaritjes së treguesit në fjalë është si vijon (sipas Horrigam, 1968)³³:

$$\text{Qarkullimi i inventarit} = \text{kostoja e mallrave të shitura} \div \text{inventari mesatar}$$

Qarkullimi i të arkëtueshmeve

Raporti i qarkullimit të llogarive të arkëtueshme llogaritet duke pjesëtuar të ardhurat neto me të arkëtueshmet mesatare. Ky raport është një masë sesa shpejt dhe me efikasitet një kompani mbledh mbi faturat e saj të papaguara. Qarkullimi i llogarive të arkëtueshme tregon sesa herë në periudhë kompania mbledh dhe kthen në para llogaritë e arkëtueshme të klientëve të saj. (Horrigam, 1968)³⁴

Një qarkullim i lartë krahasuar me atë të firmave tjera do të thotë që mjetet monetare grumbullohen më shpejt për përdorim në kompani, por duhet të analizojmë raportin e qarkullimit në lidhje me konkurrentët e firmës.

³⁰JAMES O. Horrigam, "A short History of Financial Ratio Analysis", Accounting Review, 1968, vol. 43, nr. 2.

³¹JAMES O. Horrigam, "A Short History of Financial Ratios Analysis", Accounting Review, 1968, vol. 43, nr. 2, fq. 45.

³²JAMES O. Horrigam, "A Short History of Financial Ratios Analysis", Accounting Review, 1968, vol.43, nr.2, fq. 46.

³³JAMES O. Horrigam, "A Short History of Financial Ratios Analysis", Accounting Review, 1968, vol. 43, nr. 2, fq. 46.

³⁴JAMES O. Horrigam, "A Short History of Financial Ratios Analysis", Accounting Review, 1968, vol. 43, nr. 2, fq. 48.

Pra, formula e llogaritjes së treguesit në fjalëeshtë si vijon (sipas Horrigam, 1968)³⁵:

$$\text{Qarkullimi i të arkëtueshmeve} = \text{të ardhurat neto} \div \text{të arkëtueshmet mesatare}$$

Qarkullimi i borxhit

Obligimet e pagesës maten sa shpejt një kompani paguan paratë që i detyrohen furnizuesve. Raporti llogaritet duke pjesëtuar blerjet (me kredi) me detyrimet mesatare (Horrigam, 1968)³⁶. Një numër i lartë në krahasim me mesataren e industrisë tregon se firma po i paguan kreditorët shpejt dhe anasjelltas. Një raport jashtëzakonisht i lartë mund të sugjerojë që një firmë nuk po shfrytëzon kredinë që u është ofruar atyre, ose mund të jetë rezultat i kompanisë që përfiton nga ulja e pagesave të hershme.

Pra, formula e llogaritjes së treguesit në fjalëeshtë si vijon (sipas Horrigam, 1968)³⁷:

$$\text{Qarkullimi i borxhit} = \text{blerjet} \div \text{detyrimet mesatare të pagueshme}$$

Qarkullimi i aseteve (mjeteve)

Qarkullimi i mjeteve mat sa efikase një kompani përdor asetet e saj totale për të gjeneruar të ardhura (Horrigam, 1968)³⁸. Formula për të llogaritur këtë raport është thjesht kur të ardhurat neto pjesëtohen me mjetet mesatare gjithsej. Një raport i ulët i qarkullimit të aktiveve mund të nënkuptojë që firma është joefikase në përdorimin e aseteve të saj ose se operon në një mjedis intensiv të kapitalit.

Pra, formula e llogaritjes së treguesit në fjalëeshtë si vijon (sipas Horrigam, 1968)³⁹:

$$\text{Qarkullimi i aseteve} = \text{të ardhurat neto} \div \text{mjetet mesatare totale}$$

Raportet e likuiditetit

Raportet e likuiditetit janë disa nga raportet më të përdorura gjerësisht, ndoshta krahas raporteve të përfitimit. Ato janë veçanërisht të rëndësishme për kreditorët. Këto raporte matin aftësinë e një firme për të përmbushur detyrimet e saj afatshkurtra (Horrigam, 1968)⁴⁰.

Niveli i likuiditetit të nevojshëm ndryshon nga industria në industri. Disa industri kanë më shumë para se të tjerët. Për shembull, dyqanet ushqimore do të duhet më shumë para për të

³⁵JAMES O. Horrigam, "A Short History of Financial Ratios Analysis", Accounting Review, 1968, vol. 43, nr. 2, fq. 48.

³⁶JAMES O. Horrigam, "A Short History of Financial Ratios Analysis", Accounting Review, 1968, vol. 43, nr. 2, fq. 49.

³⁷JAMES O. Horrigam, "A Short History of Financial Ratios Analysis", Accounting Review, 1968, vol. 43, nr. 2, fq. 49.

³⁸JAMES O. Horrigam, "A Short History of Financial Ratios Analysis", Accounting Review, 1968, vol. 43, nr. 2, fq. 51.

³⁹JAMES O. Horrigam, "A Short History of Financial Ratios Analysis", Accounting Review, 1968, vol. 43, nr. 2, fq. 51.

⁴⁰JAMES O. Horrigam, "A Short History of Financial Ratios Analysis", Accounting Review, 1968, vol. 43, nr. 2, fq. 53.

blerë inventarin vazhdimisht se firmat e softuerit, kështu që raportet e likuiditetit të kompanive në këto dy industri nuk janë të krahasueshme me njëri-tjetrin. Është gjithashtu e rëndësishme të vihet në dukje trendi i një kompanie në raportet e likuiditetit me kalimin e kohës.

Raportet për matjen e likuiditetit të përdorura në këtë studim bazuar në Horrigam (1968)⁴¹ janë:

- (1) raporti aktual,
- (2) raporti i shpejtë dhe
- (3) raporti i parasë së gatshme

Raporti i tanishëm

Raporti i tanishëm matë aktivet aktuale të një kompanie ndaj detyrimeve të saj të tanishme. Raporti aktual tregon nëse kompania mund të paguajë detyrimet e saj afatshkurtra në rast emergjence duke likuiduar aktivet e saj të tanishme (Horrigam, 1968)⁴².

Aktivitet rrjedhëse përfshijnë zërat bilancor siç janë: paraja dhe ekuivalentët e parasë, llogaritë e arkëtueshme, inventari, etj. Duhet theksohet se një raport i ulët aktual tregon se një firmë mund të ketë kohë të vështirë të paguajë detyrimet e tanishme në afat të shkurtër dhe meriton hetimapo ekzaminim të mëtejshëm.

Një raport aktual nën 1.00x, për shembull, do të thotë që edhe nëse kompania likuidon të gjitha pasuritë e saj aktuale, ajo ende nuk do të jetë në gjendje të mbulojë detyrimet e saj aktuale.

Pra, formula e llogaritjes së treguesit në fjalë është si vijon (sipas Horrigam, 1968)⁴³:

$$\text{Raporti aktual} = \text{aktivet afatshkurtra} \div \text{detyrimet rrjedhëse}$$

Raporti i shpejtë

Raporti i shpejtë është një raport i likuiditetit që është më i rreptë se raporti aktual. Ky raport krahason paratë e gatshme, letrat me vlerë të tregtueshme afatshkurtra dhe llogaritë e arkëtueshme ndaj detyrimeve të tanishme. Mendimi prapa raportit të shpejtë është se disa zëra bilancor, siç janë shpenzimet e parapaguara, tashmë janë paguar për përdorim në të ardhmen dhe nuk mund të konvertohen shpejt dhe lehtë në para të gatshme për qëllime likuiditeti (Horrigam, 1968)⁴⁴.

Pika kryesore e përjashtuar në raportin e shpejtë është inventari, i cili mund të përbëjë një pjesë të madhe të asetëve aktuale, por nuk mund të konvertohet lehtësisht në para të gatshme.

Pra, formula e llogaritjes së treguesit në fjalë është si vijon (sipas Horrigam, 1968)⁴⁵:

$$\text{Raporti i shpejtë} = (\text{cash} + \text{letrat me vlerë të tregtueshme afatshkurtra} + \text{llogaritë e arkëtueshme}) \div \text{detyrimet rrjedhëse}$$

⁴¹JAMES O. Horrigam, "A Short History of Financial Ratios Analysis", Accounting Review, 1968, vol. 43, nr. 2, fq. 53.

⁴²JAMES O. Horrigam, "A Short History of Financial Ratios Analysis", Accounting Review, 1968, vol. 43, nr. 2, fq. 54.

⁴³JAMES O. Horrigam, "A Short History of Financial Ratios Analysis", Accounting Review, 1968, vol. 43, nr. 2, fq. 54.

⁴⁴JAMES O. Horrigam, "A Short History of Financial Ratios Analysis", Accounting Review, 1968, vol. 43, nr. 2, fq. 55.

⁴⁵JAMES O. Horrigam, "A Short History of Financial Ratios Analysis", Accounting Review, 1968, vol. 43, nr. 2, fq. 55.

Raporti i parasë

Raporti më konservativ i likuiditetit është raporti i keshit, i cili llogaritet thjesht si mjete monetare dhe letra me vlerë të tregtueshme afatshkurtra të pjesëtua me detyrimet aktuale (Horrigam, 1968)⁴⁶. Paratë e gatshme dhe letrat me vlerë afatshkurtra përfaqësojnë asetet më likuide të një firme.

Pra, formula e llogaritjes së treguesit në fjalë është si vijon (sipas Horrigam, 1968)⁴⁷:

$$\text{Raporti i parasë së gatshme} = (\text{cash} + \text{letrat me vlerë të tregtueshme afatshkurtra}) \div \text{detyrimet aktuale}$$

Treguesit e aftësisë paguese

Raportet e aftësisë paguese matin aftësinë e një kompanie për të përmbushur detyrimet e saj më afatgjata. Analiza e raporteve të aftësisë paguese siguron depërtim në strukturën e kapitalit të një kompanie, si dhe nivelin e levës financiare që një firmë përdorë. Disa raporte të aftësisë paguese u lejojnë investitorëve të shohin nëse një firmë ka flukse të mjaftueshme të parasë për të paguar vazhdimisht pagesat e interesit dhe pagesa të tjera fikse. Nëse një kompani nuk ka flukse të mjaftueshme të parasë, firma ka shumë gjasa të mbingarkohet me borxhe dhe mbajtësit e obligacioneve mund ta detyrojnë kompaninë të falimentojë. Kemi disa lloje të raporteve që matin aftësinë paguese si: (1) raporti i borxhit ndaj aktiveve, (2) raporti i borxhit ndaj kapitalit, (3) raporti i mbulimit të interesave (Horrigam, 1968)⁴⁸.

(1) Raporti i borxhit ndaj aktiveve

Raporti borxh / aktive është raporti më i ulët i aftësisë paguese, duke matur përqindjen e totalit të aktiveve të kompanisë që financohet nga borxhi. Ky raport llogaritet duke pjesëtuar detyrimet totale me aktivet gjithsej (shih në vijim). Një numër ose tregues i lartë nënkupton se firma po përdor një sasi më të madhe të levës financiare, e cila rritë rrezikun e saj financiar në formën e pagesave të interesit fiks (Horrigam, 1968)⁴⁹.

$$\text{Raporti borxh/ aktive} = \text{totali i detyrimeve} \div \text{totali i aktiveve}$$

(2) Raporti borxh/ kapital

Raporti borxh-kapital është shumë i ngjashëm, duke matur shumën e kapitalit të përgjithshëm të kompanisë (detyrimet plus kapitalin) që sigurohet nga borxhi (Horrigam, 1968)⁵⁰. Edhe një herë, një raport i lartë do të thotë levë e lartë financiare dhe kuptohet rrezik. Megjithëse leva financiare krijon rrezik shtesë financiar me rritjen e pagesave fikse të interesit, përfitimi kryesor për përdorimin e borxhit është që ai të mos pakësojë pronësinë.

⁴⁶ JAMES O. Horrigam, "A Short History of Financial Ratios Analysis", Accounting Review, 1968, vol.43,nr. 2, fq. 57.

⁴⁷ JAMES O. Horrigam, "A Short History of Financial Ratios Analysis", Accounting Review, 1968, vol. 43, nr. 2, fq. 57.

⁴⁸ JAMES O. Horrigam, "A Short History of Financial Ratios Analysis", Accounting Review, 1968, vol. 43 nr. 2, fq. 61.

⁴⁹ JAMES O. Horrigam, "A Short History of Financial Ratios Analysis", Accounting Review, 1968, vol. 43 nr. 2, fq. 62.

⁵⁰ JAMES O. Horrigam, "A Short History of Financial Ratios Analysis", Accounting Review, 1968, vol. 43 nr. 2, fq. 63.

Pra, formula e llogaritjes së treguesit në fjalë dhe interpretimit paraprakë është si vijon (për më shumë shih, për shembull, Horrigam, 1968)⁵¹:

$$\text{Raporti i borxhit / kapitalit} = \text{borxhi total} \div (\text{borxhi total} * \text{kapitali aksionar i përgjithshëm})$$

$$\text{Raporti i borxhit / kapitalit} = \text{borxhi total} \div \text{kapitali aksionar i përgjithshëm}$$

(3) Raporti i mbulimit të interesave

Raporti i mbulimit të interesit, matë flukset monetare të kompanisë të gjeneruar në krahasim me pagesat e interesit. Raporti llogaritet duke pjesëtuar EBIT (fitimet para interesit dhe taksave) me pagesat e interesit. Sa më e lartë treguesi në fjalë, aq më pak mundësi që një kompani podështonnë përmbushjen e detyrimeve të saj (të shlyerjes së borxheve). Pra, një tregues i lartëdo të thotë që një kompani gjeneron fitime të forta (të mjaftueshme) në krahasim me detyrimet e saj të interesit.

Kështu, treguesi në fjalë llogaritet si vijon sipas interpretimit paraprakë:

$$\text{Raporti i mbulimit të interesit} = \text{fitimet para interesit dhe taksave} \div \text{pagesat e interesit}$$

Raportet e përfitueshmërisë

Përqindjet e përfitueshmërisë janë ndoshta raporti më i përdorur gjerësisht në analizën e investimeve. Këto raporte përfshijnë raporte të tilla si: marzha bruto, operativ dhe fitimi neto, etj. Këto raporte matin aftësinë e firmës për të fituar ose realizuar një kthim adekuat. Kuptohet, edhe këtu kur analizohen treguesit në fjalë është gjithmonë e rëndësishme të krahasohen me ato të industrisë dhe konkurrentëve të ngushtë të biznesit që shqyrtohet.

Margjinat treguesit ndryshojnë midis industrive. Kompanitë që veprojnë në industritë ku produktet janë kryesisht “mallra” (produkte që mund të kopjohen lehtësisht nga firma të tjera) zakonisht do të kenë kufij të ulët. Industritë që ofrojnë produkte unike me barriera të larta për hyrje në përgjithësi kanë kufij të lartë. Përveç kësaj, kompanitë mund të kenë avantazhe kyçe konkurruese që çojnë në rritje të marzhave. Në këtë kategori kemi këto raporte (sipas Horrigam, 1968)⁵²:

- (1) fitimi marzhinal bruto,
- (2) fitimi marzhinal operativ,
- (3) fitimi marzhinal neto,
- (4) kthimi i aktiveve ROA dhe
- (5) kthimi në kapital ROE.

(1) Fitimi marzhinal bruto

⁵¹JAMES O. Horrigam, “A Short History of Financial Ratios Analysis”, Accounting Review, 1968, vol. 43 nr. 2, fq. 63.

⁵²JAMES O. Horrigam, “A Short History of Financial Ratios Analysis”, Accounting Review, 1968, vol. 43, nr. 2, fq. 67.

Fitimi marzhinal bruto paraqet të ardhurat bruto (të ardhura minus koston e mallrave të shitura) të pjesëtuar me të ardhurat neto (Horrigam, 1968)⁵³. Raporti pasqyron vendimet e çmimeve dhe kostot e produktit.

Pra, formula e llogaritjes së treguesit në fjalë është si vijon (sipas Horrigam, 1968)⁵⁴:

$$\text{Fitimi marzhinal bruto} = \frac{\text{të ardhurat bruto}}{\text{të ardhurat neto}}$$

(2) Fitimi marzhinal operativ

Fitimi marzhinal operativ llogaritet duke pjesëtuar të ardhurat operative me të ardhurat neto. Shpenzimet operative përfshijnë kosto të tilla si: shpenzimet administrative dhe shpenzimet e tjera që nuk mund t'i atribuohen njësisë të produktit të vetëm. Marzhi operativ shqyrton marrëdhënien ndërmjet shitjeve dhe kostove të kontrolluara nga menaxhimi. Rritja e marzhit të operimit shihet përgjithësisht si një shenjë e mirë, por investitorët thjesht duhet të kërkojnë margjina të forta operationale (Horrigam, 1968)⁵⁵.

Pra, formula e llogaritjes së treguesit në fjalë është si vijon (sipas Horrigam, 1968)⁵⁶:

$$\text{Fitimi marzhinal operativ} = \frac{\text{të ardhurat operative}}{\text{të ardhurat neto}}$$

(3) Fitimi marzhinal neto

Fitimi marzhinal neto krahason të ardhurat neto të kompanisë me të ardhurat neto të saj. Ky raport llogaritet duke ndarë të ardhurat neto, ose linjën fundore të kompanisë, nga të ardhurat neto. Ai matë aftësinë e një firme për të përkthyer shitjet në të ardhura për aksionarët. Edhe një herë, investitorët duhet të kërkojnë kompanitë me margjina të forta dhe të qëndrueshme neto të fitimit (Horrigam, 1968)⁵⁷.

Pra, formula e llogaritjes së treguesit në fjalë është si vijon (sipas Horrigam, 1968)⁵⁸:

$$\text{Fitimi marzhinal neto} = \frac{\text{të ardhura neto}}{\text{të ardhura neto}}$$

(4, 5) ROA dhe ROE

Gjithashtu përdoren gjerësisht dy raporte të tjera të përfitimit: kthimi nga aktivet (ROA) dhe kthimi në kapital (ROE), dhe sidomos nga pronarët ose aksionarët e firmës.

Kthimi mbi aktivet llogaritet si e ardhur neto e pjesëtuar nga totali i aktiveve (Horrigam, 1968)⁵⁹. Është një masë sesa efikase një firmë përdor asetet e saj. Një raport i lartë do të thotë që kompania është në gjendje të gjenerojë në mënyrë efikase fitimet duke përdorur asetet e saj. Si

⁵³JAMES O. Horrigam, "A Short History of Financial Ratios Analysis", Accounting Review, 1968, vol. 43, nr. 2, fq. 68.

⁵⁴JAMES O. Horrigam, "A Short History of Financial Ratios Analysis", Accounting Review, 1968, vol. 43, nr. 2, fq. 68.

⁵⁵JAMES O. Horrigam, "A Short History of Financial Ratios Analysis", Accounting Review, 1968, vol. 43, nr. 2, fq. 69.

⁵⁶JAMES O. Horrigam, "A Short History of Financial Ratios Analysis", Accounting Review, 1968, vol. 43, nr. 2, fq. 69.

⁵⁷JAMES O. Horrigam, "A Short History of Financial Ratios Analysis", Accounting Review, 1968, vol. 43, nr. 2, fq. 70.

⁵⁸JAMES O. Horrigam, "A Short History of Financial Ratios Analysis", Accounting Review, 1968, vol. 43, nr. 2, fq. 70.

⁵⁹JAMES O. Horrigam, "A Short History of Financial Ratios Analysis", Accounting Review, 1968, vol. 43, nr. 2, fq. 72.

një variacion, disa analistë dëshirojnë të llogarisin kthimin e aktiveve nga fitimet paraprake dhe para interesit duke përdorur EBIT të pjesëtuar me totalin e aktiveve.

Ndërsa kthimi nga aktivet matë të ardhurat neto, që është kthimi në zotëruesit e kapitalit, kundrejt totalit të aktiveve, të cilat mund të financohen nga borxhi dhe kapitali, kthimi nga kapitali matë neto të ardhurat pa dividendë të preferuar kundrejt kapitalit total të aksionarëve (Horrigam, 1968)⁶⁰. Ky raport mat nivelin e të ardhurave që u atribuohen aksionarëve ndaj investimit që aksionarët i vënë në firmë. Ai merr parasysh sasinë e borxhit, ose levave financiare, që përdor një firmë.

Pra, formulat e llogaritjes së treguesve në fjalë janë si vijon (sipas Horrigam, 1968)⁶¹:

$$\begin{aligned} \text{Kthimi i aktiveve (ROA)} &= \text{të ardhurat neto} \div \text{totali i aktiveve} \\ \text{Kthimi në kapital (ROE)} &= \text{të ardhurat neto} \div \text{kapitali aksionar} \end{aligned}$$

Në fund të këtij diskutimi mund të thuhet se analiza e raporteve ose treguesve financiarë është një formë e analizës fundamentale që lidhë së bashku pasqyrat financiare të përpiluara dhe duhet ti shërbejë vendimmarrjes afariste. Raportet ofrojnë shifra të dobishme që janë të krahasueshme në industri dhe sektorë. Duke përdorur raportet financiare, investitorët mund të zhvillojnë një ndjesi për tërheqjen e një kompanie bazuar në pozicionin e saj konkurrues, forcën financiare dhe rentabilitetin (THACHAPPILLY, 2009)⁶².

2.2. Roli i analizës së pasqyrave financiare në vendimmarrjen afariste

Objektivi i analizës financiare dhe interpretimi i saj është që të vlerësohen fuqitë dhe dobësitë e kompanisë, duke ndërtuar kështu strategjitë në përputhje me sfidat dhe targetet e përcaktuara nga menaxhmenti. Nuk ekziston një formulë magjike apo e gatshme për një analizë korrekte dhe pa gabime, por ka mjete që udhëzojnë gjatë procesi mjaft kompleks.

Vlerësimi dhe analiza e burimeve dhe përdorimeve të fondeve lejon që analisti financiarë të vërejë me qartë se ku janë shpenzuar/investuar paratë dhe nga vinë ato, që mund të jetë një indikator i strategjisë financiare të kompanisë.

Investitorë individual ose kompani që janë të interesuara që të investojnë në biznese të vogla ose edhe në përmirësimin e gjendjes së kompanisë së tyre, i përdorin teknikat e analizës financiare për të vlerësuar informacionet financiare të kompanisë.

Duke analizuar raportet financiare të kaluara dhe ato të tashme (bilanci i gjendjes, bilanci i suksesit, rrjedhja e parasë, etj.), investitorët potencial apo ato realë mund më lehtë të marrin vendime mbi investime të ndryshme duke e pasur më të qartë vlerën e investimit si dhe pritjet nga performanca e ardhshme e kompanisë.

⁶⁰JAMES O. Horrigam, "A Short History of Financial Ratios Analysis", Accounting Review, 1968, vol. 43, nr. 2, fq. 73.

⁶¹JAMES O. Horrigam, "A Short History of Financial Ratios Analysis", Accounting Review, 1968, vol. 43, nr. 2, fq. 72-73.

⁶²THACHAPPILLY, Gopinathan, "Financial Ratio Analysis for Performance Check: Financial Statement Analysis with Ratios Can Reveal Problem Areas", 2009, fq. 203.

Analiza financiare është e dobishme edhe për pronarët e bizneseve pasi që ata analizojnë efektet e vendimeve të ndryshme, sikurse është huazimi apo financimi në njërën anë dhe investimet e planifikuara në anën tjetër.

Analiza financiare luan një rol të rëndësishëm në planifikim si një hallkë mjaft e rëndësishme në procesin e gjithëmbarshtëm menaxhuese në kompani. Duke analizuar pasqyrat financiare të kompanisë, duke interpretuar trendet dhe duke identifikuar fuqitë dhe dobësitë e saj, mund të marrim informacione të mjaftueshme që menaxhmenti ta ketë më të lehtë për të bërë parashikime të të ardhurave dhe fitimit. Këto parashikime mund të mbulojnë periudha të ndryshme kohe, mund të jenë mujore, vjetore, madje deri në tre ose pesë vjetët e ardhshme.

Duke pasur njohuri të mjaftueshme mbi trendet e ekonomisë në përgjithësi si dhe mbi ato të industrisë ku operon kompania, menaxherët mund të formojnë një vlerësim të arsyeshëm sesa mirë ose keq mund të performon kompania në vitet-periudhat që vijnë. Ndonëse, ky është edhe momenti i zbërthimit apo zbatimit të analizës së pasqyrave financiare dhe efektet apo dobitë që sjellë nëvendimmarrjen afariste si e tillë.

2.3. Informacioni kontabël dhe përdoruesit

Pasqyrat financiare reflektojnë efektet të cilat vijnë nga transaksionet e ndryshme biznesore në kompani. Ato janë shumë ngushtë të lidhura me njëra tjetrën, ku ndryshimet te njëra pasqyrë financiare reflektohen menjëherë tek pasqyra tjetër. Grupe të ndryshme të njerëzve janë të interesuar në pasqyrat financiare dhe analizën e tyre me qëllim të vlerësimit të pozitës ekonomike dhe financiare të çdo biznesi apo industrie në aspektin e profitabilitetit, likuiditetit apo në aspektin e aftësisë paguese. Te këto grupe përfshihen (TRACY, 2004)⁶³:

1. Menaxherët kërkojnë pasqyrat financiare për të menaxhuar aktivitetet e kompanisë duke vlerësuar performancën dhe pozitën financiare të saj dhe duke marrë vendime të rëndësishme biznesore.
2. Pronarët/Aksionarët përdorin pasqyrat financiare për të vlerësuar riskun dhe kthimin nga investimi i tyre në kompani dhe marrja e vendimeve investuese bazuar në analizën e tyre.
3. Investitorët potencial kanë nevojë për pasqyrat financiare për të vlerësuar gjendjen financiare të kompanisë, rentabilitetin e saj, si dhe për të parashikuar fitimin në të ardhmen.
4. Institucionet financiare (për shembull bankat) përdorin pasqyrat financiare për të vendosur se a do t'i jep kredi kompanisë a jo në bazë të likuiditetit të kompanisë.
5. Furnitorët kanë nevojë të vlerësojnë pasqyrat financiare për të analizuar gjendjen financiare të kompanisë në mënyrë që të vendosin nëse do të furnizojnë material me pagesë me kredi, pasi që duhet të sigurohen se ato do të paguhen.
6. Blerësit përdorin pasqyrat financiare të vlerësojnë nëse furnitori ka burimet e nevojshme për të siguruar furnizim të vazhdueshëm edhe në të ardhmen. Kjo është e

⁶³TRACY, John A., "How to Read a Financial Report: Wringing Vital Signs Out of the Numbers", John Wiley and Sons, 2004, fq. 112.

rëndësishme kur konsumatori është i varur nga furnitori për një komponentë të specializuar.

7. Punëtorët janë të interesuar për pasqyrat financiare për të parë profitabilitetin e kompanisë si dhe mundësinë e saj për të paguar atë edhe në të ardhmen dhe për të siguruar punën.

8. Konkurrentët krahasojnë performancën e tyre me konkurrentët për të mësuar dhe zhvilluar strategji të reja për të përmirësuar konkurrencën e tyre.

9. Publiku i gjerë mund të jetë i interesuar në ndikimin e kompanisë në ekonomi, mjedisin jetësor dhe bashkësinë lokale.

10. Qeveria kërkon pasqyrat financiare për të përcaktuar apo llogaritur saktësinë e tatimeve të deklaruara në kthimin e tatimeve. Gjithashtu mban llogari të zhvillimit ekonomik nga analiza e pasqyrave financiare të bizneseve nga sektorët e ndryshëm të ekonomisë.

2.4. Studimet paraprake dhe evidenca empirike

Shumë studime janë kryer për të krahasuar karakteristikat financiare të grupeve të ndryshme të organizatave – entiteteve (për shembull, bankave tregtare kundrejt firmave si entitete jo financiare), duke analizuar gjendjen dhe performancën financiare përmes analizave dhe teknikave/qasjeve nga më të ndryshme metodologjike.

Krahasimii karakteristikave financiare të firmave në segmente, industri apo vende të ndryshme është imirëseardhur sepse besohet se firmat brenda një segmenti të veçantë siç është industria, vendi apo koha madje pritet të janë homogjene dhe se këto mund të paraqesin faktorë të rëndësishëm në vendimmarrjen menaxheriale. Për shembull, shih studimin që lidhet me krahasimin e raporteve financiare të firmave në vende të ndryshme (rasti SHBA dhe Japoni (MERIC dhe MERIC, 1994).

Studimi i OSADDY, AKHMETSHI, AMIROVA, BOCHKAREVA, GAYIYZANOVA, ZUMASHEV, (2018), është të përmirësojë konceptin e përgatitjes së pasqyrave financiare të kompanisë si një bazë informacioni për marrjen e vendimeve në një ekonomi transformuese.

AYAD SHAKER SULTAN (2014), nëpërmjet studimit të tij përpiqet të analizojë pasqyrat financiare dhe të masë performancën në terma të përdorimit të pasurive dhe përfitimit. Në detaje, metodologjia e hulumtimit e përdorur për studimin është përqendruar në performancën e kaluar dhe të tanishme të industrisë së pijeve të klasifikuara në Bagdad. Studimi thjesht mbështetet në të dhëna dytësore, të cilat janë mbledhur për një periudhë dhjetë vjeçare (2004 deri në Shtator 2013) nga raportet vjetore të audituara të kompanisë dhe të mirëmbajtura dhe të vëna në dispozicion nga disa organizata.

PARITHRA dhe GURUKRISHAN (2018), objektivi kryesor i këtij studimi është kryerja e një studimi të shkurtër mbi bilancin e BSNL. Objektivat e këtij projekti janë: të identifikojë pasuritë e ndryshme të BSNL në lidhje me Raportet Vjetore të BSNL, të studiojë funksionimin e departamentit të financave, studim krahasues i raporteve vjetore dy vjeçare.

Studim mbi vlerësimin e performancës financiare kanë bërë edhe PAVITHRA, THOOZAMANI DHE DKHAR (2017), mbi kompaninë JEPPIAAR CEMENTS PVT LTD. Ky studim përfshin klasifikimin e marrëdhënieve të informacionit i llogaritur për problemin që është hulumtuar. Këtu, studiuesi përdor mjete të ndryshme për analizimin e të dhënave duke shfrytëzuar raportet financiare si dhe metodat për analizimin e bilanceve të kompanisë.

Treguesit financiar që lidhen qoftë me gjendjen apo performancën financiare janë ekzaminuar nga mjaft autorë duke u shtrirë për mostra dhe vende të ndryshme, madje duke inkorporuar edhe faktorët e mjedisit të jashtëm dhe sidomos efektet e krizave të ndryshme ekonomike – financiare.

Studimet janë thelluar më tej duke hulumtuar për shembull lidhjen në mes profitabilitetit në një rën anë dhe në anën tjetër karakteristikave të firmës (investimet në kapitalin punues, kredia tregtare, ngarkesa me borxh, madhësia e firmave, etj.), lidhjen profitabilitet-likuiditet, etj. Për shembull, shih studimet, krahas mjaft të tjerave, si nga aspekti metodologjik por edhe atë empirik: MADALENO, MISU dhe DEARI (2019); DINCA, BARBUTA-MISU, MADALENO, DINCA dhe DEARI (2017)

3. TË DHËNAT DHE METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

3.1. Burimet e të dhënave

Si mostër-burim të dhënave kontabël kemi zgjedhur pasqyrat financiare të ndërmarrjes në fjalë për periudhën 2012-2016.

Zgjedhja e mostrës nuk është e rastësishme, por e gjykuar mirë pasi që kjo ishte periudha me interes për tu analizuar. Arsyeja e zgjedhjes së kësaj periudhe është fakti se në vitin 2014

ndërmarrja “Molika Vigjilent” ka investuar paranëduke themeluar supermarketin “Prima Center” në Tetovë.

Pasi që në këtë punim do të analizohet sesi ka ndikuar investimi në performancën financiare, studimi është shtrirë më tej duke e ndarë periudhën në dy nën-periudha, edhe atë: periudha para dhe pas investimit në mënyrë që më qartë të vërehen ndryshimet që kanë ndodhur. Pra, vitet 2012, 2013 dhe 2014 janë analizuar për të parë sesi ka qenë gjendja/performance financiare para investimit dhe vitet pasuese 2015 dhe 2016 janë analizuar për të vërejtur sesi ka ndryshuar gjendja/performance financiare e ndërmarrjeve.

Kjo do të thotë se fokusi i studimit është analiza dhe studimi i gjendjes/performancës financiare në drejtim të përgjigjes së pyetjes bazë nëse është përkeqësuar apo përmirësuar ose ka ngelur e njëjtë. Gjithashtu, më tej si të dhëna shumë të rëndësishme do të jenë edhe të dhënat e gjeneruar nga pyetëtori me menaxherët dhe pronarët e ndërmarrjeve në fjalë.

3.2. Rasti i studimit

Firma “Molika Vigjilent, sh.p.k.” Tetovë është ndërmarrje private që merret me prodhimin si dhe eksport-importin e mobiljeve, në veçanti dhomave të gjumit.

Është themeluar më 26.07.1990. Në vitin 2010 ajo bleu shumicën e aksioneve të shoqërisë aksionare “Industriski Ladilnik” dhe u bë aksionarja kryesore me një përqindje të lartë të aksioneve duke e marrë të drejtën e udhëheqjes mbi këtë ndërmarrje, ndërsa në vitin 2014 themeloi edhe supermarketin “Prima Center”.

Supermarketi “Prima Center” është themeluar me datën 21.10.2014 nga ana e ndërmarrjes “Molika Vigjilent, sh.p.k.” Tetovë. Veprimtaria e këtij supermarketi është shitblerja e artikujve të konsumit të gjërë si dhe në kuadër të tij funksionon edhe restoranti me po të njëjtin emër.

Ndërmarrja private “Molika Vigjilent dhe të tjerët” Doo eksport-import, Tetovë – Shoqëria për prodhim, transport, tregti dhe shërbime “Molika Vigjilent dhe të tjerë” Doo eksport-import, me vendndodhje në rrugën Video Smilevski Bato, pa numër në Tetovo, është e regjistruar në regjistrin tregtar me numrin regjistruar 02020676-3-03-000, me datën e themelimit në 26.07.1990.

Emri i shkurtër i shoqërisë është “Molika Vigjilent” Doo Tetovë. Kompania merret me prodhimin e mobileve. Bënë prodhimin e dhomave të gjumit për të rritur dhe për fëmijë, komodina si dhe orendi të tjera. Ndërmarrja posedon teknologji moderne, e cila përdoret ekskluzivisht për prodhimin e mobileve. E gjithë teknologjia që ka është nga prodhues të njohur si CSM, Biese Giardina, Orma, Homag, Veke, etj.

Në fillim të themelimit të saj, ndërmarrja “Molika Vigjilent” filloi biznesin e saj vetëm me 8 punëtorë, ndërsa sot ajo ka më shumë se 50 punëtorë. Kompania produktet e saj i plasoi si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Ajo ka bashkëpunëtorë në tregun e huaj me të cilët ka ndërtuar një bashkëpunim shumë të mirë tash për disa vjet.

3.3.Hipotezat

Hipotezat e ngritura në këtë studim dalin dhe lidhen ngushtë me qëllimet e studimit. Atëherë, përmes intervistimit të menaxherëve të firmës dhe metodologjisë së përdorur do mblidhen të dhëna sasiore (pra nga bilanci) dhe cilësore (nga pyetësi) lidhur me atë nëse ato kanë bërë vlerësimin e gjendjes dhe performancës financiare në vendimet afariste.

Thënë, ndryshe nëse vendimet e realizuara gjatë kësaj periudhe kanë qenë racionalë dhe tëarsyeshëm në kuptim të riskut dhe kthimit të implikuar afarist dhe financiarë. Në anën tjetër, përmes analizave do të tregohet se cila është gjendja dhe performanca financiare e firmës dhe si rekomandohet të jenë të njëjtat në kuptim të përmirësimit në të ardhmen.

Më tej, realizimi i investimit afatgjatë – themelimi i supermarketit “Prima Center” a është bërë mbi bazën e analizës së pasqyrave financiare apo është vendim i bazuar në përvojë dhe të dhëna të tjera nga tregu (vendime rutine). Pra, investimi në fjalë a është bërë mbi bazën e arsyeshmërisë financiare dhe i bazuar në informacionin kontabël dhe financiar?

Si rrjedhojë, do të ishte me interes qëmenaxhmenti i firmës të jetë i informuar për përmirësimin apo përkeqësimin e gjendjes dhe performancës financiare pas këtij investimi.

Marrë në përgjithësi diskutimi i mësipërm mund tëgërshetohet dhe të rezultojë nëradhitjen e hipotezave që mendohet të analizohen në këtë studim si vijon:

H1₀ – Menaxherët kanë bërë vlerësimin e gjendjes dhe performancës financiare në vendimmarrje gjatë periudhës 2012-2016.

H1_a – Menaxherët nuk kanë bërë vlerësimin e gjendjes dhe performancës financiare në vendimmarrje gjatë periudhës 2012-2016.

H2₀ – Investimi afatgjatë – themelimi i supermarketit “Prima Center” ka përmirësuar gjendjen dhe performancën financiare të firmës “Molika Vigilent, sh.p.k.” Tetovë.

H2_a – Investimi afatgjatë – themelimi i supermarketit “Prima Center” ka përkeqësuar gjendjen dhe performancën financiare të firmës “Molika Vigilent, sh.p.k.” Tetovë.

Pranimi apo refuzimi i hipotezave të mësipërme do të realizohet përmes një analize dhe studimi të gjithëmbarshtëm të gjendjes dhe performancës financiare të firmës “Molika Vigilent, sh.p.k.” Tetovë për periudhën 2012-2016.

Në funksion të kësaj, do të realizohet edhe një intervistë-pyetësor me menaxherët e firmës “Molika Vigilent, sh.p.k.” Tetovë për të marrë gjykimin, opinionin, perceptimin dhe kuptimin e analizës së pasqyrave financiare si instrument që ndihmon vendimmarrjen.

Kështu, gërshetimi i të dhënave sasiore dhe cilësore do të nxjerrë përfundime më përmbajtësore dhe cilësore. Këto të dhëna do të analizohen përmes një metodologjie të përgjithshme dhe specifike të fushës së analizës së pasqyrave financiare.

3.4. Metodologjia e hulumtimit

Metodologjia e hulumtimit e ndjekur në këtë punim ngërthen hapat, procedurat dhe rrugën që nisët nga e përgjithshmja tek ajo konkrete duke përdorur dy metodat shkencore: kryesisht metodat kuantitative. Por, në pjesë të caktuara përdoret edhe analiza kualitative meqenëse bisedohet për pjesën e pyetësorit.

Metoda kuantitative i referohet interpretimit matematikor dhe statistikor të rezultatit. Nga ana tjetër metoda shkencore kualitative nuk është një metodë e strukturuar por një metodë subjektive e cila shpjegon mendimet e brendshme dhe emocionet e hulumtuesit (GUMMESSON, 2000)⁶⁴.

Ashtu siç u cekë më herët, fillimisht të dhënat primare lidhur me gjendjen dhe performancën financiare të firmës gjatë viteve 2012-2016 do të merren si referencë.

Të dhënat primare përfshijnë bilancin e gjendjes dhe pasqyrën e të ardhurave apo bilancin e suksesit, por edhe të dhëna të tjerë që lidhen me biznesin në fjalë (të dhëna kontabël-financiarë dhe të tjera) për vitin 2012, 2013, 2014, 2015 dhe 2016.

Këto të dhëna nuk janë përdorur më herët në një studim të ngjashëm si ky andaj paraqesin të dhëna bazë dhe primare. Më tej do të shfrytëzohen të dhëna të tjera jo nga pasqyrat financiare, pra jo vetëm me karakter kontabël-financiar (siç u prezantua firma më herët – rasti i studimit).

Firma e përfshirë në hulumtim është “Molika Vigjilent, sh.p.k.” Tetovë. Të dhënat kontabël do të përdoren për të llogaritur treguesit financiarë dhe për të realizuar një sërë analizash të mirënjohura në fushën e analizës financiare si: analizën vertikale, horizontale apo të tendencës, etj.

Pastaj krahasimi kuantitativ i firmës, që nënkupton llogaritjen matematikore të raporteve financiare. Për më tepër krahasimi kuantitativ do të mbështetet nga komentet dhe diskutimet edhe kualitative dhe informacionet e përfituara nga analiza e pasqyrave financiare. Në mbështetje të kësaj, do të përdoren të dhënat e gjeneruar nga intervistimi-pyetësi (gërshetohen të dhënat dhe komentet e rezultateve të përfituara).

Gjithashtu për të analizuar raportet financiare do të përdoret edhe metoda krahasuese, e cila nënkupton krahasimin e rezultateve përfundimtare apo të dhënave që kemi në dispozicion. Me anë të kësaj metode krahasohen rezultatet e një subjekti me një tjetër për të parë se cila është më e mirë si dhe të një periudhe me një tjetër. Në rastin konkret do të krahasohen raportet financiare të firmës për të parë sesi ka ndryshuar performanca/gjendja financiare e firmës gjatë kësaj periudhe, para dhe pas investimit, apo me normat-standardet e njohura, etj.

4. ANALIZA DHE DISKUTIMI I REZULTATEVE

Në kuadër të këtij kreu do të realizohen analizat e mirënjohura në fushën e analizës së pasqyrave financiare dhe të njëjtat më pastaj përmes rezultateve të përfituar do të shërbejnë si bazë për rekomandime të mundshme në drejtim të përmirësimit të gjendjes dhe performancës financiare të rastit studimor – subjektit afarist.

Fillimisht këtu prezantohet bilanci i gjendjes i krahasuar për periudhën 2012 – 2016 dhe më pastaj vazhdohet përmes analizës së ndryshimeve (rritje ose zvogëlim) vit pas viti, pra të analizës horizontale.

⁶⁴GUMMESSON, Evert, “Qualitative Methods in Management Research”, 2000, fq. 12.

4.1. Analiza horizontale

Bilanci i gjendjes


Tabela1: Bilanci i gjendjes

(000 mijë denarë)


Nr	Përshkrimi	2012	2013	2014	2015	2016
A	Mjetet themelore	247.152	257.596	264.178	292.307	295.750
1	Mjetet jomateriale	15.602	17.120	17.415	18.850	19.157
2	Mjetet material	166.998	175.923	182.211	207.110	210.245
a	Patundshmëritë	99.902	110.379	119.002	130.746	130.875
b	Toka	15.388	15.388	15.388	15.388	15.388

c	Objekte ndërtimi	84.514	94.991	103.614	115.358	115.487
d	Impiante dhe pajisje	67.096	65.544	63.209	76.363	79.371
3	Investime financiare afatgjate	64.552	64.552	64.552	66.347	66.347
B	Mjetet qarkulluese	61.703	75.004	93.814	78.823	89.082
1	Stoqet	9.065	22.957	15.913	14.518	23.713
2	Llogaritë e arkëtueshme	48.048	47.845	73.694	60.176	64.692
a	Kërkesa nga kompanitë e lidhura		5.803	6.882	9.129	7.095
b	Kërkesat nga blerësit	36.382	34.458	55.610	46.656	52.816
c	Kërkesa për dhënien e avanceve			1.101	1.924	4.487
d	Kërkesa nga shteti	11.667	7.584	10.077	2.444	293
e	Kërkesa të tjera afatshkurta			24	24	
4	Mjete financiare afatgjate				1.334	594
5	Mjetet monetare dhe letrat me vlerë	4.590	4.201	4.207	2.794	83
a	Mjete monetare	71	99	357	45	83
b	Ekuivalent të parave	4.518	4.103	3.850	2.749	
	AKTIVA (A+B)	308.855	332.599	357.992	371.129	384.832
A	Kapitali vet dhe rezervat	80.002	96.149	100.912	108.390	118.953
1	Kapitali vet	30.004	30.004	30.004	30.004	30.004
2	Rezerva					6.478
3	Fitimi i akumuluar	36.254	49.997	66.145	70.908	71.908
4	Fitimi për vitin financues	13.744	16.148	4.762	7.478	10.563
B	Detyrimet	228.853	236.450	257.080	262.739	265.879
1	Detyrimet afatgjate			9.580	56.793	62.874
a	Detyrime afatgjate ndaj furnitorëve				42.217	46.255
b	Detyrime për avance, depozita				14.576	
c	Detyrime për kreditë			9.580		16.619
2	Detyrimet afatshkurta	228.853	236.450	247.500	205.946	203.004
a	Detyrime ndaj furnitorëve	31.637	32.858	50.557		
b	Detyrime për tatime dhe kontr.rrogave	222	252	243	283	295
c	Detyrime ndaj të punësuarve	437	495	471	559	581
d	Detyrime tatimore aktuale		32			150
e	Detyrime ndaj huave dhe kredive	196.557	202.813	195.745	204.709	201.745
d	Detyrime tjera afatshkurta			483	395	233
	PASIVA (A+B)	308.855	332.599	357.992	371.129	384.832

Grafikoni1:Aktivët e bilancit të gjendjes



Grafikoni 2: Pasiva e bilancit të gjendjes




Rritja dhe zvogëlimi i zërave në bilancin e gjendjes


Tabela 2: Rritja dhe zvogëlimi i zërave të bilancit të gjendjes (000 mijë denarë)

Nr	Përshkrimi	Rritja/zvogëlimi 2012/2013	Rritja/zvogëlimi 2013/2014	Rritja/zvogëlimi 2014/2015	Rritja/zvogëlimi 2015/2016
A	Mjetet themelore	10.444	6.582	28.129	3.443
1	Mjetet jomateriale	1.518	295	1.435	307
2	Mjetet material	8.925	6.288	24.899	3.135
a	Patundshmëritë	10.477	8.623	11.744	129
b	Toka	/	/	/	/
c	Objekte ndërtimi	10.477	8.623	11.744	129
d	Impiante dhe pajisje	(1.552)	(2.335)	13.154	3.008
3	Investime financiare afatgjate	/	/	1.795	/
B	Mjetet qarkulluese	13.301	18.810	(14.991)	10.259
1	Stoqet	13.892	(7.044)	(1.395)	9.195
2	Llogaritë e arkëtueshme	(203)	25.849	(13.518)	4.516
a	Kërkesa nga kompanitë e lidhura	5.803	1.079	2.247	(2.034)
b	Kërkesat nga blerësit	(1.924)	21.152	(8.954)	6.160
c	Kërkesa për dhënien e avanceve	/	1.101	823	2.563
d	Kërkesa nga shteti	(4.083)	2.493	(7.633)	(2.151)
e	Kërkesa të tjera afatshkurta	/	24	/	(24)
4	Mjete financiare afatgjate	/	/	1.334	(740)
5	Mjetet monetare dhe letrat me vlerë	(389)	6	(1.413)	(2.711)
a	Mjete monetare	28	258	(312)	38
b	ekuivalent të parave	(415)	(253)	(1.101)	(2.749)
	AKTIVA (A+B)	23.744	25.393	13.137	13.703
A	Kapitali vet dhe rezervat	16.147	4.763	7.478	10.563
1	Kapitali vet	/	/	/	/
2	Rezerva	/	/	/	6.478
3	Fitimi i akumuluar	13.743	16.148	4.763	1.000
4	Fitimi për vitin finances	2.404	(11.386)	2.716	3.085
B	Detyrimet	7.597	20.630	5.659	3.140
1	Detyrimet afatgjate	/	9.580	47.213	6.081
a	Detyrime afatgjate ndaj furnitorëve	/	/	42.217	4.038
b	Detyrime për avance, depozita	/	/	14.576	(14576)
c	Detyrime për kreditë	/	9.580	(9.580)	16.619
2	Detyrimet afatshkurta	7.597	11.050	(41.554)	(2.942)
a	Detyrime ndaj furnitorëve	1.221	17.699	(50.557)	/
b	Detyrime për tatime dhe kontr.rrogave	30	(9)	40	12
c	Detyrime ndaj të punësuarve	58	(24)	88	22
d	Detyrime tatimore aktuale	32	(32)	/	150
e	Detyrime ndaj huave dhe kredive	6.256	(7.068)	8.964	(2.964)
d	Detyrime tjera afatshkurta	/	483	(88)	(162)
	PASIVA (A+B)	23.744	25.393	13.137	13.703

Grafikoni 3: Rritja dhe zvogëlimi i zërave të bilancit të gjendjes - Aktiva



Grafikoni 4: Rritja dhe zvogëlimi i zërave të bilancit të gjendjes - Pasiva




Bilanci i suksesit

Tabela 3: Bilanci i suksesit (000 mijë denarë)

Nr.	Përshkrimi	2012	2013	2014	2015	2016
1	Të hyrat e përgjithshme	144.926	161.480	158.001	142.919	143.125
a	Të hyrat nga shitja	132.913	153.022	158.001	142.869	141.724
b	Të hyrat e tjera	12.013	8.458		50	1.401
	Stoqet e mallrave në fillim të vitit	4.714	5.696	4.765	4.765	4.006
	Stoqet e mallrave në fund të vitit	5.696	5.696	4.765	4.006	12.421
2	Të dalat e përgjithshme	129.581	136.248	152.314	133.081	132.554
a	Shpenzime për lëndën e parë dhe materialet	7.997	13.444	116.950	101.623	102.985
b	Vlera furnizuese e mallrave të shitura	89.020	98.582			2.311
c	Shërbime me karakter te shpenzimeve materiale	13.951	7.103	17.728	14.108	10.355
d	Shpenzimet e tjera nga puna	4.902	3.624	3.566	3.590	2.627
e	Shpenzimet për të punësuarit	7.400	9.306	9.875	8.978	10.020
-	Rroga neto dhe kontributet	5.207	6.089	5.889	6.254	6.636
-	Shpenzimet e tjera për të punësuarit	2.193	3.217	2.540	2.724	2.962
-	Shpenzime të tjera për të punësuarit			1.447		421
f	Amortizimi dhe zhvlerësimi	3.530	3.492	3.629	3.852	3.649
g	Shpenzime të tjera	2.780	697	565	930	607
3	Të hyra financiare					7
a	Të hyra nga kamata/kurset e këmbimit					7
4	Të dala financiare	1.602	9.085	924	1.600	8.010
a	Shpenzime financiare nga marrëdhëniet me shoqëri të lidhura	1.597	8.881	924		
b	Shpenzime nga kamata				1.393	8.010
c	Shpenzime nga dallimet e kursit të këmbimit		203		207	
d	Shpenzime të tjera financiare	4				
e	Pjesëmarrje në humbjen e shoqërive të lidhura	984				
5	Fitimi para tatimit	13.744	16.148	4.762	7.478	10.983
6	Tatimi në fitim					420
7	Fitimi neto	13.744	16.148	4.762	7.478	10.563

Grafikoni 5: Bilanci suksesit




Rritja dhe zvogëlimi i zërave në Bilancin e Suksesit

Tabela 4: Rritja dhe zvogëlimi i zërave në bilancin e suksesit (000 mijë denarë)

Nr.	Përshkrimi	Rritja/zvogëlimi 2012/2013	Rritja/zvogëlimi 2013/2014	Rritja/zvogëlimi 2014/2015	Rritja/zvogëlimi 2015/2016
1	Të hyrat e përgjithshme	16.554	(3.479)	(15.082)	203
a	Të hyrat nga shitja	20.109	4.979	(15.132)	(1.145)
b	Të hyrat e tjera	(3.555)	(8.458)	50	1.351
	Stoqet e mallrave në fillim të vitit	982	(931)		(759)
	Stoqet e mallrave në fund të vitit		(931)	(759)	8.415
2	Të dalat e përgjithshme	6.667	16.066	(19.233)	(527)
a	Shpenzime për lëndën e parë dhe materialet	5.447	103.506	(15.327)	1.362
b	Vlera furnizuese e mallrave të shitura	9.562			2.311
c	Shërbime me karakter te shpenzimeve materiale	(6.848)	10.625	(3.620)	(3.753)
d	Shpenzimet e tjera nga puna	(1.278)	(58)	24	(963)
e	Shpenzimet për të punësuarit	1.906	569	(897)	1.042
-	Rroga neto dhe kontributet	882	(200)	365	382
-	Shpenzimet e tjera për të punësuarit	1.024	(677)	184	238
-	Shpenzime të tjera për të punësuarit		1.447	(1.447)	421
f	Amortizimi dhe zhvlerësimi	(38)	137	223	(203)
g	Shpenzime të tjera	(2083)	(132)	365	(323)
3	Të hyra financiare				7
a	Të hyra nga kamata/kurset e këmbimit				7
4	Të dala financiare	7483	(8.161)	676	6.410
a	Shpenzime financiare nga marrëdhëniet me shoqëri të lidhura	7.284	(7.957)	(924)	
b	Shpenzime nga kamata			1393	6.617
c	Shpenzime nga dallimet e kursit të këmbimit	203	(203)	207	(207)
d	Shpenzime të tjera financiare	(4)			
e	Pjesëmarrje në humbjen e shoqërive të lidhura	(984)			
5	Fitimi para tatimit	2.404	(11.386)	16	3.505
6	Tatimi në fitim				420
7	Fitimi neto	2404	(11.386)	16	3.085

Grafikoni6: Rritja dhe zvogëlimi i zërave në bilancin e suksesit




4.2. Analiza vertikale

Bilanci i gjendjes

Tabela5: Analiza vertikale-Bilanci i gjendjes

Nr	Përshkrimi	2012	2013	2014	2015	2016
A	Mjetet themelore	80%	77%	74%	79%	77%
1	Mjetet jomateriale	5%	5%	5%	5%	5%
2	Mjetet material	54%	53%	51%	56%	55%
a	Patundshmëritë	32%	33%	33%	35%	34%
b	Toka	5%	5%	4%	4%	4%
c	Objekte ndërtimi	27%	29%	29%	31%	30%
d	Impiante dhe pajisje	22%	20%	18%	21%	21%
3	Investime financiare afatgjate	21%	19%	18%	18%	17%
B	Mjetet qarkulluese	20%	23%	26%	21%	23%
1	Stoqet	3%	7%	4%	4%	6%
2	Llogaritë e arkëtueshme	16%	14%	21%	16%	17%
a	Kërkesa nga kompanitë e lidhura		2%	2%	2,5%	2%
b	Kërkesat nga blerësit	12%	10%	16%	13%	14%
c	Kërkesa për dhënien e avanceve			0,31%	0,5%	1%
d	Kërkesa nga shteti	4%	2%	3%	0,7%	0,08%
e	Kërkesa të tjera afatshkurta			0,006%	0,006%	
4	Mjete financiare afatgjate				0,4%	0,15%
5	Mjetet monetare dhe letrat me vlerë	2%	1%	1%	0,8%	0,02%
a	Mjete monetare	0,02%	0,03%	0,1%	0,012%	0,02%
b	Ekuivalent të parave	1,5%	1%	1%	0,7%	
	AKTIVA (A+B)	100%	100%	100%	100%	100%
A	Kapitali vet dhe rezervat	26%	29%	28%	29%	31%
1	Kapitali vet	10%	9%	8%	8%	8%
2	Rezerva					2%
3	Fitimi i akumuluar	12%	15%	18%	19%	19%
4	Fitimi për vitin financues	4%	5%	1%	2%	3%
B	Detyrimet	74%	71%	72%	71%	69%
1	Detyrimet afatgjate			3%	15%	16%
a	Detyrime afatgjate ndaj furnitorëve				11%	12%
b	Detyrime për avance, depozita				4%	
c	Detyrime për kreditë			3%		4%
2	Detyrimet afatshkurta	74%	71%	7%	55%	53%
a	Detyrime ndaj furnitorëve	10%	10%	14%		
b	Detyrime për tatime dhe kontr.rrogave	0,07%	0,08%	0,07%	0,08%	0,08%
c	Detyrime ndaj të punësuarve	0,14%	0,15%	0,001%	0,15%	0,15%
d	Detyrime tatimore aktuale		0,01%			0,04%
e	Detyrime ndaj huave dhe kredive	64%	61%	55%	55%	52%
d	Detyrime tjera afatshkurta			0,1%	0,11%	0,06%
	PASIVA (A+B)	100%	100%	100%	100%	100%

Grafikoni7: Analiza vertikale-Bilanci i gjendjes




Bilanci i suksesit


Tabela6: Analiza vertikale-Bilanci i suksesit

Nr.	Përshkrimi	2012	2013	2014	2015	2016
1	Të hyrat e përgjithshme	100%	100%	100%	100%	100%
a	Të hyrat nga shitja	92%	95%	100%	100%	99%
b	Të hyrat e tjera	8%	5%		0.03%	1%
	Stoqet e mallrave në fillim të vitit					
	Stoqet e mallrave në fund të vitit					
2	Të dalat e përgjithshme	89%	84%	96%	93%	93%
a	Shpenzime për lëndën e parë dhe materialet	6%	8%	74%	71%	72%
b	Vlera furnizuese e mallrave të shitura	61%	61%			2%
c	Shërbime me karakter të shpenzimeve materiale	10%	4%	11%	10%	7%
d	Shpenzimet e tjera nga puna	3%	2%	2%	3%	2%
e	Shpenzimet për të punësuarit	5%	6%	6%	6%	7%
-	Rroga neto dhe kontributet	4%	4%	4%	4%	4%
-	Shpenzimet e tjera për të punësuarit	1%	2%	2%	2%	2%
-	Shpenzime të tjera për të punësuarit			0.9%		0.3%
f	Amortizimi dhe zhvlerësimi	2%	2%	2%	3%	3%
g	Shpenzime të tjera	2%	0.4%	0.4%	0.7%	0.4%
3	Të hyra financiare					0.005%
a	Të hyra nga kamata/kurset e këmbimit					0.005%
4	Të dala financiare	1%	6%	1%	1%	6%
a	Shpenzime financiare nga marrëdhëniet me shoqëri të lidhura	1%	5%	1%		
b	Shpenzime nga kamata				0.97%	6%
c	Shpenzime nga dallimet e kursit të këmbimit		0.13%		0.13%	
d	Shpenzime të tjera financiare	0.003%				
e	Pjesëmarrje në humbjen e shoqërive të lidhura	0.7%				
5	Fitimi para tatimit	10%	10%	3%	6%	8%
6	Tatimi në fitim					0.3%
7	Fitimi neto	10%	10%	3%	6%	7%

Grafikoni8: Analiza vertikale-Bilanci i suksesit



Grafikoni 9: Analiza vertikale-Bilanci i suksesit (vazhdon)




4.3. Analiza e trendit

Bilanci i gjendjes

Tabela7: Analiza e trendit-Bilanci i gjendjes

Nr	Përshkrimi	2012	2013	2014	2015	2016
A	Mjetet themelore	100	104	107	118	120
1	Mjetet jomateriale	100	110	112	121	123
2	Mjetet material	100	105	104	124	126
a	Patundshmëritë	100	110	119	131	131
b	Toka	100	100	100	100	100
c	Objekte ndërtimi	100	112	123	137	137
d	Impiante dhe pajisje	100	98	94	114	118
3	Investime financiare afatgjate	100	100	100	103	103
B	Mjetet qarkulluese	100	120	152	128	144
1	Stoqet	100	253	176	150	262
2	Llogaritë e arkëtueshme	100	99,6	153	125	135
a	Kërkesa nga kompanitë e lidhura	0	100	119	157	123
b	Kërkesat nga blerësit	100	95	153	128	145
c	Kërkesa për dhënien e avanceve	0	0	100	175	408
d	Kërkesa nga shteti	100	65	86	21	2.5
e	Kërkesa të tjera afatshkurta	0	0	100	100	0
4	Mjete financiare afatgjate	0	0	0	100	45
5	Mjetet monetare dhe letrat me vlerë	100	92	92	61	1.8
a	Mjete monetare	100	139	503	63	117
b	ekuivalent të parave	100	91	85	61	0
	AKTIVA (A+B)	100	108	116	120	125
A	Kapitali vet dhe rezervat	100	120	126	135	149
1	Kapitali vet	100	100	100	100	100
2	Rezerva	0	0	0	0	100
3	Fitimi i akumuluar	100	138	182	196	198
4	Fitimi për vitin financues	100	118	35	54	77
B	Detyrimet	100	103	112	115	116
1	Detyrimet afatgjate	0	0	100	592	656
a	Detyrime afatgjate ndaj furnitorëve	0	0	0	100	110
b	Detyrime për avance, depozita	0	0	0	100	0
c	Detyrime për kreditë	0	0	100	0	174
2	Detyrimet afatshkurta	100	103	108	90	89
a	Detyrime ndaj furnitorëve	100	104	160	0	0
b	Detyrime për tatime dhe kontr.rrogave	100	114	109	127	133
c	Detyrime ndaj të punësuarve	100	113	108	128	133
d	Detyrime tatimore aktuale	0	100	0	0	469
e	Detyrime ndaj huave dhe kredive	100	103	100	104	103
d	Detyrime tjera afatshkurta	0	0	100	82	48
	PASIVA (A+B)	100	108	116	120	125

Grafikoni 10: Analiza e trendit-Bilanci i gjendjes




Bilanci i suksesit

Tabela8: Analiza e trendit- Bilanci i suksesit

Nr.	Përshkrimi	2012	2013	2014	2015	2016
1	Të hyrat e përgjithshme	100	112	109	99	99
a	Të hyrat nga shitja	100	115	119	108	107
b	Të hyrat e tjera	100	70	0	0.4	12
	Stoqet e mallrave në fillim të vitit	100	121	101	101	85
	Stoqet e mallrave në fund të vitit	100	100	84	70	218
2	Të dalat e përgjithshme	100	105	118	103	102
a	Shpenzime për lëndën e parë dhe materialet	100	168	1462	1271	1288
b	Vlera furnizuese e mallrave të shitura	100	111	0	0	3
c	Shërbime me karakter të shpenzimeve materiale	100	51	127	101	74
d	Shpenzimet e tjera nga puna	100	74	73	73	54
e	Shpenzimet për të punësuarit	100	126	133	121	135
-	Rroga neto dhe kontributet	100	117	113	120	127
-	Shpenzimet e tjera për të punësuarit	100	147	116	124	135
-	Shpenzime të tjera për të punësuarit	0	0	100	0	29
f	Amortizimi dhe zhvlerësimi	100	99	103	109	103
g	Shpenzime të tjera	100	25	20	33	22
3	Të hyra financiare	0	0	0	0	100
a	Të hyra nga kamata/kurset e këmbimit	0	0	0	0	100
4	Të dala financiare	100	567	58	100	500
a	Shpenzime financiare nga marrëdhëniet me shoqëri të lidhura	100	556	58	0	0
b	Shpenzime nga kamata	0	0	0	100	575
c	Shpenzime nga dallimet e kursit të këmbimit	0	100	0	102	0
d	Shpenzime të tjera financiare	100	0	0	0	0
e	Pjesëmarrje në humbjen e shoqërive të lidhura	100	0	0	0	0
5	Fitimi para tatimit	100	117	35	54	80
6	Tatimi në fitim	0	0	0	0	100
7	Fitimi neto	100	117	35	54	77

Grafikoni11: Analiza e trendit- Bilanci i sukcesi




4.4. Treguesit financiarë

Në vazhdim jepet një përmbledhje e treguesve financiarë duke i kategorizuar në grupe si vijon dhe më pastaj bëhet prezantimi përmes grafikoneve përkatëse.


Tabela9: Treguesit financiarë

Raportet financiare	2012	2013	2014	2015	2016
Raportet e aktivitetit					
1. Qarkullimi i inventarit	10.7	4.9	7.4	7	4.4
2. Qarkullimi i të arkëtueshmeve	121	108	171	154	165
3. Qarkullimi i borxhit	646	635	594	566	561
4. Qarkullimi i mjeteve	0.47	0.49	0.44	0.39	0.37
Raportet e likuiditetit					
1. Raporti i tanishëm	0.27	0.32	0.38	0.38	0.44
2. Raporti i shpejtë	0.23	0.22	0.32	0.31	0.32
3. Raporti i parasë	0.02	0.02	0.02	0.14	0.004
Treguesit e aftësisë paguese					
1. Raporti i borxhit ndaj aktiveve	0,74	0,71	0,72	0,71	0,69
2. Raporti i borxhit/kapitalit	2.86	2.46	2.55	2.42	2.24
Raportet e përfitueshmërisë					
1. Fitimi marzhinal bruto	33%	31%	26%	29%	26%
2. Fitimi marzhinal operativ	11%	16%	4%	6%	13%
3. Fitimi marzhinal neto	9%	10%	3%	5%	7%
4. ROA	4,45%	4,86%	1,33%	2,02%	2,74%
5. ROE	17,18%	16,79%	4,72%	6,9%	9,23%


Grafikoni12: Raportet e aktivitetit




Grafikoni13: Raportet e likuiditetit




Grafikoni14: Treguesit e aftësisë paguese




Grafikoni 15: Raporti borxh/kapital



Grafikoni 16: Raportet e përfitueshmërisë



Grafikoni 17: ROA dhe ROE



4.5. Analiza krahasimore e treguesve financiar, para dhe pas investimit në “Prima Center”

Ekzistojnë dëshmi empirike nga hulumtimet të ndryshme se në bizneset e orientuara në prodhim, prioritetet më të zakonshme i referohen rritjes së performancës së produktit, kënaqësisë së konsumatorëve dhe investimeve në zhvillimin dhe inovacionin, reduktimin e kostos, sistemet e planifikimit të resurseve, përmirësimin e zinxhirit të furnizimit, trajnimin e punonjësve dhe përfshirjen e tyre në procesin e përmirësimit të vazhdueshëm, ndaj politikave mjedisore (NELGADDE, 2010)⁶⁵.

Në kontekstin e rastit studimor, nga analiza e raporteve financiare të kryer më lart, tregohet një paqëndrueshmëri ose variaciontë shumëve të ndryshme, me një rënie apo rritjetëpërgjithshme gjatë viteve, por e cila fillon të përmirësohet përgjithësisht pas vitit 2014 në kuptim të gjendjes dhe performancës financiare.

Kompania “Molika Vigjilent” në fund të vitit 2014 ka investuar në themelimin e supermarketit Prima Center siç u elaborua më herët. Nga analiza e raporteve dhe pasqyrave financiare të kompanisë Molika kemi vërejtur se kompania ka përjetuar në lëvizje lart e poshtë të treguesve financiarë.

Në vitin 2014 ka pasur më shumë vështirësi nga të gjitha vitet, ku shihet edhe te raportet të cilat kanë pësuar rënie si dhe te fitimi i kompanisë i raportuar në fund të vitit, i cili është ulur me 11.386.000 denarë. Në fund të këtij viti, në bazë të analizave të tregut si dhe në bazë të intuitës së vetë pronarit, themelohet supermarketi Prima Center, në kuadër të të cilit kemi edhe restorantin.

Pas vitit 2014 tregohet një përmirësim i të gjithave raporteve financiare duke vazhduar të rriten si në vitin 2015 ashtu edhe në vitin 2016. Prima Center si kompani doli mjaft e suksesshme, me një qarkullim të konsiderueshëm vjetor, duke ndihmuar kështu në mënyrë financiare kompaninë Molika.

Marrë në përgjithësi periudhën e analizës 2012 – 2016 biznesi në fjalë ka pasur një trend pozitiv lidhur me të dalat e përgjithshme, për dallim nga të hyrat e përgjithshme të cilat megjithatë kanë përjetuar një trend negativ. Si rezultat, fitimi neto i gjeneruar ka shënuar një trend negativ të përgjithshëm gjatë periudhës së analizës.

Megjithatë, për çështje të analizave të mëtejshme dhe nxjerrjen e një rezultati sa më bindës, periudha e përgjithshme siç u cekë më herë është ndarë në dy nën-periudha: deri në vitin 2014 dhe pas vitit 2014. Ajo që nxirret si rezultat mjaft domethënës është se fitimi neto si agregati kryesor dhe përmbajtësor i aktivitetit afarist të biznesit deri në vitin 2014 shënon një trend mjaft të theksuar rënës i dëshmuar me ekuacionin: $y = -4.491x + 20.53$, $R^2 = 0.56$ dhe për periudhën 2015 – 2016 shënon një trend mjaft rritës sipas ekuacionit: $y = 3.09x + 4.39$, $R^2 = 1.00$. Në terma të përqindjes, fitimi neto në vitin 2016 në krahasim me vitin 2014 shënon një rritje për 122%.

⁶⁵NELGADDE, Jo. “Inventory Analysis: A Guide to Analyzing Inventory for Small Business Owners”, 2010, fq. 26.

Përmirësimi i performancës financiare pas vitit 2014 dëshmohet edhe me dy treguesit bazë dhe agregat të përfitueshmërisë si: ROA dhe ROE ku analizat e mësipërme prezantuan trendin dhe rezultatet e realizuara.

Në anën tjetër, edhe gjendja financiare e biznesit sa vinë e përmirësohet, për shembull, në qoftë se analizohen dy treguesit e likuiditetit, si raporti i tanishëm dhe ai i shpejtë përfundohet se trendi është shpresëdhënës dhe pozitivë. Për shembull, raporti i tanishëm në vitin 2016 në krahasim me vitin 2014 shënon një rritje për 16%, kurse në anën tjetër raporti i borxhit ndaj aktiveve bie me 4% sipas të njëjtit krahasim.


Nga kjo dëshmohet se vendimi dhe investimi i marrë për të themeluar supermarketin doli i suksesshëm dhe rezultoi në rritjen e profitabilitetit dhe likuiditetit të kompanisë Molika. Me anë të kësaj analize vërtetojmë edhe hipotezën H_{20} se investimi afatgjatë – themelimi i supermarketit “Prima Center” ka përmirësuar gjendjen dhe performancën financiare të firmës “Molika Vigjilent, sh.p.k.” Tetovë.

4.6. Analiza me skenarë – Informatat relevante

Kompania Molika në vitin 2014 pati një rënie të fitimit të saj nga 16 milion denarë në 4,7 milion denarë. Kjo erdhi si pasojë e rritjes shumë të madhe të shpenzimeve të lëndës së parë të materialeve punuese. Edhe pse të hyrat e përgjithshme janë rritur, por rritja e tyre nuk është aspak në proporcion me rritjen e shpenzimeve të lëndës së parë.

Arsyeja se pse ka ardhur deri te kjo mendohet se mund të jetë rritja e çmimeve të lëndës së parë si dhe shitja e artikujve me marzhë shumë të ulët. Sidoqoftë në vitin 2015 vërejmë ndryshime, ku kemi ulje të këtyre shpenzimeve me një vlerë prej 16 milion denarë e cila ka çuar direkt në rritjen e fitimit të përgjithshëm të kompanisë me 3 milion denarë. E njëjta rritje ka vazhduar edhe në vitin 2016.

Grafikoni 18: Shpenzimet për lëndën e parë



Më tej, në fund të vitit 2014 kompania Molika ka investuar në hapjen e supermarketit Prima Center, ku në të përfshihen edhe restoranti, pjesa për lojërat e fëmijëve si dhe pjesa ku shiten mobilet dhe shumica e mobileve janë të prodhuara nga vetë kompania Molika. Kjo i ka ndihmuar që të ulë shpenzimet dhe të risë shitjet duke rritur çmimet në mënyrë adekuate me një marzhë të favorshme për kompaninë, por njëkohësisht duke mos dëmtuar edhe konsumatorët.

Gjithashtu, Prima Center i ka paguar edhe qira mujore të arsyeshme kompanisë Molika duke i shtuar të ardhurat fikse të saj në një vlerë prej 8 milion denarë vjetore.

Të gjitha këto ndryshime mund të shihen edhe në vlerat e zërave bilancor të pasqyrave të financiare si dhe në llogaritjen etreguesve financiare sesi kanë ndryshuar përgjatë viteve.

Ashtu siç u prezantua më herët, raportet e përfitueshmërisë në vitin 2014 kanë pësuar rënie të dukshme, por me ndryshimet e shumta është arritur që të përmirësohen në vitet në vijim.

Sipas analizës së bërë në këtë punim u dëshmua se investimi që ka bërë kompania Molika në hapjen e supermarketit Prima Center ka ndikuar pozitivisht në performancën financiare të saj. Megjithatë, nëse nuk do të investonte atëherë do të rezultonte në një skenarë ndryshe në pasqyrat financiare. Fitimi i saj do të vazhdonte të pësonte rënie duke dobësuar performancën financiare (siç u prezantua trendi – dinamika e rezultatit), por padyshim do të reflektonte gjendjen financiare deri sa pronarët dhe menaxherët të gjenin një zgjidhje tjetër në funksion për të përmirësuar të njëjtat.

Në vazhdim, për të argumentuar përmes shifrave këtë konstatim është realizuar një simulim financiar i bilancit të suksesit dhe në fakt tabela 10 prezanton informatat relevante. Pra, sesi ishte performanca financiare para dhe pas investimit. Kolona e fundit tregon efektin neto, respektivisht diferencën nga investimi i realizuar – efektet e gjeneruara deri në zërin e fundit bilancor, atë të fitimit neto.

Tabela 10: Performanca para dhe pas investimit

(mijë denarë)

Nr.	Përshkrimi	Para investimit	Pas investimit	Diferenca
1	Të hyrat e përgjithshme	158.001	143.125	-14.876
a	Të hyrat nga shitja	158.001	141.724	-16.277
b	Të hyrat e tjera		1.401	+1.401
	Stoqet e mallrave në fillim të vitit	4.765	4.006	-759
	Stoqet e mallrave në fund të vitit	4.765	12.421	+7.656
2	Të dalat e përgjithshme	152.314	132.554	-19.760
a	Shpenzime për lëndën e parë dhe materialet	116.950	102.985	-13.965
b	Vlera furnizuese e mallrave të shitura		2.311	+2.311
c	Shërbime me karakter te shpenzimeve materiale	17.728	10.355	-7.373
d	Shpenzimet e tjera nga puna	3.566	2.627	-939
e	Shpenzimet për të punësuarit	9.875	10.020	+145
-	Rroga neto dhe kontributet	5.889	6.636	+737
-	Shpenzimet e tjera për të punësuarit	2.540	2.962	+422
-	Shpenzime të tjera për të punësuarit	1.447	421	-1.026
f	Amortizimi dhe zhvlerësimi	3.629	3.649	+20
g	Shpenzime të tjera	565	607	+42
3	Të hyra financiare		7	+7
a	Të hyra nga kamata/kurset e këmbimit		7	+7
4	Të dala financiare	924	8.010	+7.086
a	Shpenzime financiare nga marrëdhëniet me shoqëri të lidhura	924		-924
b	Shpenzime nga kamata		8.010	+8.010
c	Shpenzime nga dallimet e kursit të këmbimit			
d	Shpenzime të tjera financiare			
e	Pjesëmarrje në humbjen e shoqërive të lidhura			
5	Fitimi para tatimit	4.762	10.983	+6.221
6	Tatimi në fitim		420	+420
7	Fitimi neto	4.762	10.563	+5.801

Dallimi prej + 5.801.000 denarë është efekti neto që rezulton nga krahasimi me dhe pa investimin afatgjatë të realizuar nga kompania në fjalë. Kuptohet, investimi i realizuar ka rritur edhe koston financuese (shih shpenzimet e kamatës +8.010.000 denarë). Megjithatë, ka efekt kumulativ që është i favorshëm sepse biznesi ka arritur të ulë të dalat e përgjithshme më shumë sesa ka ulur të hyrat e përgjithshme. Përmirësimi i performancës financiare pritet të përmirëson edhe treguesit dhe vet gjendjen financiare.

4.7. Informacioni kontabël në funksion të vendimmarrjes – gjetjet nga analiza cilësore/sasiore

Vendimmarrja është procesi i bërjes së zgjedhjeve duke identifikuar një vendim, mbledhjen e informacionit dhe vlerësimin e rezultateve alternative. Përdorimi i një procesi vendimmarrës hap pas hapi mund t'ju ndihmojë të merrni vendime më të qëllimshme dhe të matura duke organizuar informacionin përkatës dhe duke përcaktuar alternativat. Kjo qasje rritë shanset që ju të zgjidhni alternativën më të kënaqshme të mundshme (LEWIS Mandell & THOMAS J. O'Brien, 1992)⁶⁶.

Informacioni është një nga burimet më të rëndësishme të menaxherëve kur flasim për vendimmarrje. Informatat e besueshme dhe relevante ndihmojnë në të gjitha aspektet e detyrave të menaxherëve, nga vendimmarrja deri tek kontrolli. Kur kemi mungesë të informacioneve, menaxhmenti bazohet në supozime ose hamendësime.

Menaxherët vazhdimisht marrin vendime në çdo nivel dhe marrja e vendimeve shtrihet nga vendimet strategjike deri tek vendimet rutinë operative. Në këtëkontekst kontabilistët e kompanisë kanë rol kyç në procesin e vendimmarrjes meqenëse mendohet se i furnizojnëvendimmarrësit me informacione sa sasiore ashtu edhe cilësore. Tradicionalisht dhe sotroli i kontabilistit në biznes është i padiskutuar dhe i rëndësishëm gjatë gjithë procesit të vendimmarrjesefektive dhe efikase afariste.

Kontabilistët e kompanisë mund të angazhohen për të kontribuar në çdo fazë të procesit të vendimmarrjes efektive. Ato mund të përfshihen në (GUMMESSON, 2000)⁶⁷:

- Vendosjen e kontekstit dhe inkuadrimit të çështjes që duhet marrë në konsideratë,
- Menaxhimin e performancës dhe rrezikut gjatë zbatimit dhe
- Raportimin financiar dhe narrativ të rezultateve.

Në vazhdim, ekzistojnë tri fusha kryesore ku kontabiliteti financiar ndihmon vendimmarrjen (TRACY, 2004)⁶⁸:

- Ai siguron investitorët me një bazë të analizës për dhe krahasimin mes shëndetit financiar të korporatave që lëshojnë letra me vlerë;
- Ai ndihmon kreditorët të vlerësojnë aftësinë paguese, likuiditetin dhe aftësinë kreditore të bizneseve;
- Së bashku me kontabilitetin menaxherial, kontabiliteti financiar i ndihmon bizneset të marrin vendime për mënyrën e shpërndarjes së burimeve të pakta.

Prandaj, duke u mbështetur edhe në këto pikëpamje teorike dhe burimet e të dhënave në njëerën anë dhe rezultateve të arritura në anën tjetër, mendohet tënxirren disa informacione me rëndësi që pretendojnë të ndihmojnë menaxhimin e biznesit në kuptim tëtreguesve financiarë, kryesisht që lidhen me gjendjen dhe performancën financiare.

⁶⁶LEWIS Mandell & THOMAS J. O'Brien, "Investments", 1992, fq. 156.

⁶⁷GUMMESSON Evert, "Qualitative Methods in Management Research", 2000, fq. 152.

⁶⁸TRACY, John A, "How to Read a Financial Report: Wringing Vital Signs Out of the Numbers", John Wiley and Sons, 2004, fq. 225.

Në kuadër të këtij punimi ashtu siç u prezantua, kemi analizën sasiore dhe cilësore – e cila është realizuar në bazë të një pyetësi, që u është bërë menaxherëve kryesorë, punëtorëve si dhe vetë pronarit të kompanisë Molika.

Pyetësi ka përmbajtur pyetje të lidhura me vendimmarrjen, respektivisht sa informacionet e marra nga bilancet financiare të përgatitura në kompani janë në funksion të vendimmarrjes dhe a bazohen menaxherët në po këto pasqyra financiare gjatë marrjes së vendimeve të rëndësishme.

Pyetësi u realizua me 40 persona-respondentë të cilët kanë funksione të ndryshme në kompani. Pyetësin e kanë realizuar edhe të punësuarit e thjeshtë si një evidencë nëse ato përbëjnë dhe janë përdorues të brendshëm të informacionit kontabël bashkë me menaxherët. Rëndom ato nuk kanë shumë njohuri (dhe nuk pritët një gjë e tillë) në krahasim me menaxherët apo shefat e reparteve në lidhje me pasqyrat financiare, me përpilimin dhe kuptimin e tyre, por përbëjnë hallkë të rëndësishme në kuadër të zinxhirit të gjithëmbarshtëm menaxhues. Më tej, menaxherët, shefat e reparteve si dhe pronari kishin njohuri të mjaftueshme dhe bashkëvepronin me kontabilistët në përpilimin dhe komentimin e të njëjtave.

Duhet theksuar fillimisht se pyetjet nga e para dhe e katërta kishin të bëjnë me pjesën – strukturën e të punësuarve, ku tregohet se të punësuarit kryesisht janë meshkuj me një nivel të mesëm arsimor, pasi që shumica janë punëtorë të thjeshtë që punojnë në pjesën e prodhimit të mobileve dhe vetëm nëntë prej tyre janë në pjesën e administratës.

Të punësuarit janë kryesisht me përvojë pune, edhe atë 17 janë më përvojë nga 2 deri në 5 vite dhe 18 janë me më shumë se 5 vite. Janë vetëm 5 punëtorë që kanë përvojë punë më pak se 2 vite.

Gjatë intervistës janë marrë përgjigje nga më të ndryshme (mbase në ndonjë pyetje nuk është marrë përgjigje nga të gjithë të anketuarit) dhe në mënyrë të përmbledhur prezantohet – nxirret në pah se pasqyrat financiare përpilohen me sukses nga personat përgjegjës të kompanisë. Ata përpilojnë raporte të besueshme dhe të kuptueshme që e kuptuam nga pyetja 18 e cila pyeste për besueshmërinë e pasqyrave financiare dhe shumica e të intervistuarve, pra 35 prej tyre u përgjigjën me alternativën “shumë”.

Nga përgjigjet e pyetjeve të intervistës tregohet se gjatë vendimmarrjeve të ndryshme si dhe për zgjidhjen e problemeve të ndryshme merren parasysh përgjithësisht informacionet e marra nga analiza financiare e pasqyrave financiare. Si dhe marrja parasysh e këtyre analizave mendohet që gjatë procesit të vendimmarrjes të çon në përmirësim të realizimit të planeve dhe qëllimeve afatgjate dhe afatshkurta të kompanisë. Por, në këtë drejtim duhet bërë ndarja në mes pjesës operative – të punësuarve që nuk lidhen drejtpërdrejt me menaxhimin dhe të punësuarve, respektivisht menaxherëve të cilët i përdorin informacionet në vendimmarrje përgjithësisht.

Më tej, përgjigjet tjera nga pyetësi ishin si vijon dhe që është me interes të diskutohen në kontekstin e problemit të rastit studimor.

Nga përgjigjet e pyetjeve pesë, gjashtë dhe shtatë vërejmë se shumë pak nga të punësuarit janë të njoftuar me performancën financiare të kompanisë, pra shtatë persona janë përgjigjur me shumë dhe shtatë të tjerë me pak, si dhe vetëm dy mund të përpilojnë pasqyra financiare, ku në

fakt përfshihen kontabilistët dhe pesë të tjerë kanë pak informacion sesi përpilohen pasqyrat financiare.

Më tej, të anketuarit në masë të konsiderueshme dhe dominuese nuk kanë njohuri sesa shpesh përpilohen pasqyrat financiare në kompaninëku ato realizojnë aktivitetin. Kjo do të thotë edhe mungesë informacioni, por njëkohësisht që pjesa dërmuese e tëpunësuarve nuk mbështeten në pasqyrat financiare, qoftë edhe si lexues të thjeshtë. Kjo konfirmohet me përgjigjet në pyetjen e 8-të, apo avantazhet e raportimit nëpyetjen e 9-të dhe përgjigjet në pyetjen e 10-të. Në fakt, një pjesë e mirë e tëpunësuarve nuk i kuptojnë pasqyrat financiare (shih përgjigjen 12) dhe nuk kanëkërkuar nga shërbimi i kontabilitetit informata që ndihmojnë në vendimmarrje (shih përgjigjen 13), apo që nuk vlerësojnë gjendjen dhe performancën financiare të kompanisë (shih përgjigjen 14).

Ajo që është me interes të nënvizohet në këtë moment është pjesa e të punësuarve në rolin e menaxherëve. Sipas përgjigjeve të pyetjeve në vijim vërejmë se menaxhmenti i kompanisë në fjalë është i vetëdijshëm për avantazhet e përpilimit të pasqyrave financiare, që ka të bëjë me pyetjen e nëntë (9 persona përgjigjen me “Po”), si dhe gjatë marrjes së vendimeve të rëndësishme merren parasysh analiza e pasqyrave financiare, të cilën e vërejmë nga përgjigja e pyetjes njëmbëdhjetë, ku njëmbëdhjetë persona janë përgjigjur me “Po”.

Përgjigjet e pyetjeve 15 – 21 vazhdojnë të mbështesin faktin se janë pikërisht menaxherët e kompanisë janë ato të cilët përdorin, u besojnë apo që mbështesin vendimmarrjen në informacionin e gjeneruar nga sistemi kontabël. Ajo që duhet marrë në konsideratë dhe trajtohet më tej është se kjo vendimmarrje apo përdorim i analizës së pasqyrave financiare është kryesisht në nivel vjetor. Andaj, sugjerohet që informacioni financiar të raportohet dhe përdoret më shpesh sesa një herë në vit. Për më tepër, nëse raportimi financiarë është adekuat dhe përdoret në mënyrën e duhur pritet të ndikojë në rritjen dhe avancimin e kompanisë dhe sidomos në periudhë afatgjate.

Në pyetjen numër 22, e cila thotë se a janë përmirësuar planet dhe vendimmarrja si rezultat i analizës të pasqyrave financiare, 18 persona janë përgjigjur me “Po”, që do të thotë se analiza financiare ka ndihmuar në marrjen e vendimeve më të mira për kompaninë, ku si analizë të pasqyrave financiare përdorin raportet financiare, nga e cila erdhëm në përfundim prej përgjigjeve të pyetjes 23 (shfrytëzojnë raportet financiare apo kryesisht ndonjë teknik tjetër për analizë).

Në vazhdim, përgjigjet e pyetjeve 24 – 29 tregojnë se megjithatë informacioni përgjithësisht merret në kohë, deri-diku kompania krahasohet me konkurrentët, informacioni u shpërndahet përdoruesve të jashtëm dhe përgjithësisht konsiderohet i saktë dhe adekuat nga menaxhmenti.

Vlejnë të theksohen përgjigjet e pyetjes 27 dhe 28 se megjithatë ështëkoncepti i *besimit* në ndihmën që analiza e pasqyrave financiare ofron në gjetjen e zgjidhjes më të mirë për investime të ardhshme dhe se përgjithësisht rishikohen në mënyrën e duhur elementet financiare para se të merren vendimet financiare.

Pyetja e 30 kishte të bënte me dhënien e një komenti nga të anketuarit mbi punimin si dhe a jaka vlejtur investimi i bërë nga ana e Molikës. Nga komentet e shumta arritëm në përfundim se shumica mendonin se investimi ishte i arsyeshëm dhe kompania në fjalë ka pasur përfitime nga ky investim dhe tregojnë se ishte investimi më i mirë që mund të bënte kompania. Kishte edhe përgjigje të cilët nuk kishin informacion mbi përfitimet si dhe mbi investimin.

Nga përgjigjet e përfituara dhe analiza e tyre mund të vihet në disa përfundime në lidhje me procesin e vendimmarrjes si dhe lidhshmërinë dhe funksionimin e kompanisë gjatë proceseve të ndryshme brenda kompanisë. Disa nga këto përfundime dhe fushat për përmirësim janë radhitursi më poshtë:

- Këshillat/rekomandimet financiare dhe informacioni financiar - kontabël duhet të jenë në kohë dhe të besueshme për menaxherët e të gjithë sektorëve për të mbështetur përgjegjësitë dhe vendimmarrjen menaxheriale.
- Informatat financiare të vërteta dhe konzistente janë dhe të jenë të disponueshme për menaxherët në marrjen e vendimeve, në formën dhe cilësinë që ato kërkojnë (struktura, formati i raportimit, etj.).
- Informacioni financiar duhet të përbën dhe jetë pjesë integrale e programit të menaxhimit të gjithëmbarshtëm brenda kompanisë dhe mos konsiderohet kontabiliteti si një zyrë e veçantë vetëm për përpilimin e llogarive vjetore.

Nga e gjithë kjo vijmë në përfundim se gjatë marrjes së vendimeve të rëndësishme për kompaninë duhet të posedohet informacion. Menaxherët marrin në konsideratë informacionet e dalë-gjeneruar nga raportet financiare dhe në bashkëveprim me to merren vendimet e ndryshme në kompani.

Në mënyrë të përmbledhur rezultatet sinjalizojnë se hipoteza e parë dhe e dytëkonfirmohet drejtim të asaj se menaxherët megjithatë kanë bërë vlerësimin e gjendjes dhe performancës financiare në vendimmarrje gjatë periudhës 2012-2016. Kjo dëshmohet edhe përmes shifrave të raportuara në drejtim të përmirësimit të përgjithshëm, por edhe nga gjetjet e intervistimit se megjithatë investimi afatgjatë – themelimi i supermarketit “Prima Center” është vendimmarrje që ka ndikuar dhe influencuar pozitivisht kompaninë.

Rezultatet e pyetësorit në mënyrë të përmbledhur jepen në tabelën 11 si në vijim kurse forma dhe përmbajtja e pyetësorit jepet në fund të punimit.

Tabela 11: Përmbledhje e rezultateve nga pyetësori

Numri i pyetjes	a)	b)	c)	d)	e)
1	36	4	/	/	/
2	-	24	16	/	/
4	5	17	18	/	/
5	-	26	7	7	/
6	-	33	5	2	/
7	-	-	17	23	/
8	5	-	35	/	/
9	9	23	10	4	/
10	12	19	5	4	/
11	11	-	3	7	19
12	11	17	7	5	/
13	12	28	/	/	/
14	15	25	/	/	/
15	17	-	5	7	11
16	15	4	21	/	/
17	15	-	-	-	/
18	4	35	-	/	/
19	12	-	7	21	/
20	16	3	21	/	/
21	10	6	-	-	/
22	18	-	3	12	7
23	-	-	-	7	33
24	25	15	/	/	/
25	18	7	15	-	/
26	17	6	17	-	/
27	5	-	-	20	15
28	7	3	6	14	10
29	12	19	-	9	/

4.8. Përmbledhje dhe diskutimi i rezultateve

Në bazë të analizës krahasimore nga paraqitja e bilanceve si dhe treguesve financiarë të kompanisë në fjalë kemi arritur në disa përfundime të cilat si përmbledhje jepen si në vijim. Meqenëse në pjesën paraprake të diskutimit në lidhje me gjetjet nga pyetësori u analizuan rezultatet kryesisht të formës kualitative, në vijim diskutohen rezultatet sasiore të fitura nga analizat e realizuara.

Gjendja financiare –Bilanci i gjendjes

- Gjatë 5 viteve që janë analizuar kemi në përgjithësi një rritje graduale të mjeteve themelore, ku me ndikim më të madh janë patundshmëritë si dhe objektet e ndërtimit.

Tek mjetet qarkulluese, në vitet 2012 dhe 2014 tregohet një rritje e konsiderueshme, ndërsa në vitin 2015 kemi rënie të mjeteve qarkulluese me gati 15 milion denarë. Kjo rënie vjen si pasojë e uljes së mjeteve monetare dhe llogarive të arkëtueshme. Mjetet monetare janë ulur si pasojë e pagesave të disa detyrimeve ndaj furnitorëve si dhe me blerjen e mjeteve materiale. Në përgjithësi aktiva ka pasur rritje në 5 vitet e analizuara.

- Gjithashtu, kemi ulje të llogarive të arkëtueshme në vitin 2015 në shumën prej 13.518.000 denarë, ku vërejmë edhe ulje të shitjeve në vitin 2015 në shumën prej 15.132.000 denarë. Në vitin 2014 vërejmë një rritje të madhe të llogarive të arkëtueshme me 25.849.000 denarë, por kemi një rënie të shitjeve neto. Rritja kaq e madhe e llogarive të arkëtueshme në mënyrë jo-proporcionale me shitjet neto duhet të alarmon në rritje të llogarive të arkëtueshme pa shpresë arkëtimi dhe që lehtë mund të kalojnë në borxh të keq (mos arkëtohen). Kjo mund të vërehet edhe te raporti i qarkullimit të të arkëtueshmeve, ku ky raport nga viti 2013 në vitin 2014 është rritur për 63 ditë që tregon se kompanisë në fjalë i duhen më shumë ditë për të arkëtuar paratë nga klientët e saj. Kjo gjendje mund të ketëndikuar edhe në uljen e fitimit në mënyrë drastike në vitin 2014 me 11.386.000 denarë. Gjithsesi, kjo përfaqëson bllokim të parasë-likuiditetit dhe mund të detyron subjektin të huazon borxh financiar për të tejkaluar situatën. Kjo më tej implikon shpenzimet e kamatës (kostoja e borxhit) dhe menaxhmenti duhet të jetë i kujdesshëm në këtë pikë.
- Mjetet monetare kanë pasur rënie sidomos në vitet 2015 dhe 2016. Në vitin 2015 me 1.413.000 denarë, ndërsa në vitin 2016 me 2.711.000 denarë, por nga ana tjetër kemi edhe rënie të detyrimeve ndaj furnitorëve si dhe rritje të mjeteve themelore, ku mund të gjykohet se mjetet monetare janë përdorur për investime si dhe për shlyerjen e borxheve ndaj furnitorëve. Në fund të vitit 2014 është investuar në themelimin e Supermarketit Prima Center, andaj edhe vërehet rritja e kredive afatshkurta nga 2014 në 2015. Ndërsa, në anën tjetër kemi ulje të detyrimeve ndaj kredive afatgjate, që domethënë kemi shlyerje të disa borxheve ndaj kredive e cila gjithashtu mund të lidhet me uljen e mjeteve monetare.
- Gjatë viteve 2012 – 2016 kemi rritje graduale të detyrimeve gjithsej. Detyrime afatgjate kemi të regjistruara që nga viti 2014 me kreditë afatgjate dhe që mendohet se janë marrë për shkak të investimit në themelimin e Prima Center. Kjo përfaqëson një formë financimi përmes borxhit. Detyrimet afatshkurta në vitet 2015-2016 janë ulur ndoshta si pasojë e riorganizimit të zërave në bilanc, kthimin e disa detyrimeve afatshkurta në afatgjate, ku tregohet se detyrimet afatshkurta ndaj furnitorëve në vitin 2015 nuk figurojnë, ndërsa janë shtuar detyrimet afatgjatë ndaj furnitorëve si dhe detyrimet për avance dhe depozita. Te detyrimet si zë në bilanc kemi edhe pagat ndaj të punësuarve që është në rritje dhe kjo vjen si pasojë e rritjes së numrit të të punësuarve si dhe rritjen e pagave të punëtorëve aktual.

Performanca financiare – Bilanci i suksesit

- Të hyrat nga shitja kanë pasur rritje në tre vitet e para të analizuara 2012, 2013 dhe viti 2014, ndërsa në vitin 2015 kemi rënie të tyre në shumën prej 15.132.000 denarë. Ndërsa, në vitin 2016 rënia është më e vogël pra në shumën prej 1.145.000 denarë. Por, në vitin 2014 në të hyrat e përgjithshme kemi rënie me 3.479.000 denarë dhe kjo vjen si pasojë e të hyrave të tjera që ka pasur kompania në vitin 2013 në shumën prej 8.458.000 denarë. Edhe pse kemi lëvizje të të hyrave lartë e poshtë është pozitive fakti se ato mund të mbulojnë koston e mallrave të shitura në të gjitha vitet si dhe të gjitha shpenzimet e tjera që kanë ndikim në prodhimin e materialeve për shitje.
- Më tej, edhe pse nga viti 2014 në vitin 2015 ka pasur një rënie të disa zërave të bilancit të gjendjes dhe të suksesit si dhe të fitimeve të paraqitura në bilanc, mund të themi se biznesi ka filluar të marrë veten shumë shpejt në vitin 2016 duke rritur edhe fitimin.
- Në vazhdim, mund të themi se investimi (pra themelimi i saj) në Prima Center ishte një investim pozitiv për kompaninë në fjalë duke ndikuar relativisht mirë në rrjedhjen e kompanisë dhe përmirësimin e performancës financiare.

Treguesit financiarë – një përmbledhje

- Qarkullimi i inventarit – në rastin e biznesit të analizuar raporti i qarkullimit të inventarit në vitin 2012 ishte 10,7, që do të thotë se inventari u 'kthye' ose u plotësua 10,7 herë gjatë një periudhe prej një viti. Në vitet në vazhdim kemi ngritje dhe rënie të këtij raporti. Sa më i lartë është vlera e këtij raporti aq më mirë përgjithësisht për kompaninë, që do të thotë se kompania ka lëvizje të inventarit të saj. Në këtë raport ndikojnë rritja dhe zvogëlimi i vlerës së inventarit dhe koston së mallrave të shitura (KMSH).
- Qarkullimi i të arkëtueshmeve – ky raport është një masë sesa shpejt dhe me efikasitet një kompani mbledh faturat e saj të papaguara. Në kompaninë e analizuar tregohet se ky raport arrin deri 171 ditë në vitin 2014, që nuk është një sinjal përgjithësisht i mirë pasi që kompanisë i duhet shumë kohë për të kthyer shitjet e saj në para kesh dhe që drejtpërdrejt ndikon në likuiditetin e kompanisë. Duhet pasur kujdes në politikën e arkëtimit të klientëve si dhe në përzgjedhjen e tyre.
- Qarkullimi i borxhit – ky raport matë sa shpejt një kompani paguan paratë që i detyrohet furnitorëve të saj. Periudha e qarkullimit të borxhit tregon sesa ditë i duhen kompanisë që të shlyejë detyrimet e saj. Një raport i lartë tregon së kompanisë i duhen më shumë ditë për të paguar furnitorët e saj si dhe anasjelltas. Në rastin konkret, kompania në fjalë ka një vlerë shumë të lartë të këtij raporti. I njëjti duket se po ulet, por përsëri ngelet shumë i lartë. Pra, i duhet përgjithësisht shumë kohë biznesit në fjalë që të paguajë faturat apo borxhet e saj. Kjo shfaq vështirësinë që ka kompania në shpërndarjen e parave për të paguar furnitorët e saj.

- Qarkullimi i mjeteve – ky raport matë aftësinë e kompanisë për të përdorur mjetet e saj në gjenerimin e të ardhurave. Një raport i lartë është i preferueshëm, që tregon se kompania përdor me sukses mjetet e saj për të gjeneruar të ardhura. Në rastin tonë konkret kompania ka një raport jo shumë të lartë, por që shkon edhe në rëni nga viti 2012 në vitin 2016. Në vitin 2012 ka qenë 0,47 herë dhe ka arritur në 0,37 herë në vitin 2016. Kjo tregon se performanca e kompanisë është e mangët dhe menaxhmenti duhet të marrë në konsideratë marrjen e masave për të përmirësuar këtë raport. Ky raport mund të rritet me rritjen e shitjeve si dhe me ulje e aktiveve gjithsej në bilanc.
- Raporti i tanishëm – ky raport reflekton sesa herë mjetet afatshkurta të një kompanie mbulojnë obligimet afatshkurta të saj. Një raport i ulët përgjithësisht tregon se kompania mund të ketë vështirësi për të paguar detyrimet e saj. Në rastin e kompanisë së analizuar kemi një raport relativisht të ulët, por që tregohet një shpresë rritjeje. Kjo rritje vjen falë uljes së detyrimeve qarkulluese dhe rritjes së mjeteve qarkulluese në bilancin e kompanisë, por përsëri si raport ngelet i ulët.
- Raporti i shpejtë – apo ndryshe njihet si testi acid është pothuajse i njëjtë me raportin e tanishëm por minuson nga inventarin dhe merr parasysh vetëm zërat më likuid të mjeteve qarkulluese. Në shembullin e analizuar kompania përsëri ka një raport në fjalë edhe më të ulët se raporti i tanishëm. Përgjithësisht, likuiditeti i kompanisë është në një nivel jo të dëshirueshëm. Nga viti 2012 që ka qenë 0,23, në vitin 2016 ka arritur në 0,32 që do të thotë se kompania mund të mbulojë vetëm 32% të detyrimeve qarkulluese duke përdorur të gjitha mjetet e saj qarkulluese.
- Raporti i parasë – është raporti më konservativ i likuiditetit i cili llogaritet në mes mjeteve monetare dhe letrave me vlerë në përpjesëtim me detyrimet qarkulluese. Në rastin e kompanisë në fjalë ky raport është shumë i ulët dhe mund qartë të tregohet se kompania ka probleme me likuiditetin duke mos pasur mjete monetare apo para kesh në qarkullim. Kjo është alarmante dhe kompania duhet të jetë shumë e kujdesshme në këtë drejtim duke analizuar se pasojë e çfarë vjen deri tek kjo gjendje dhe përse nuk arrin të ketë para të mjaftueshme. Andaj, sugjerohet të rishikohet politika e menaxhimit të parasë në funksion të përmirësimit të mëtejshëm.

Më tej, duke marrë në përgjithësi raportet e likuiditetit dhe rezultatet e përfituara, disa sugjerime për të përmirësuar likuiditetin do të ishin si vijon:

- Kompania të zvogëlojë ditët në llogaritë e arkëtueshme për të përmirësuar aktivet aktuale dhe duke vlerësuar llogaritë e arkëtueshme në një bazë më të shpeshtë. Të ndërmerin një qëndrim-politikë më të sigurt në mbledhjen e llogarive të arkëtueshme dhe llogarive pa shpresë arkëtimi.
- Të përgatisë parashikime më të hollësishme të parasë dhe të vlerësojë aftësinë e kompanisë për të përmbushur qëllimet në baza të rregullta, madje ditore.
- Të konsiderohet pagesa e detyrimeveafatshkurta nëse pozicioni i parave të gatshme të kompanisë është i favorshëm ose nëse të njëjtin rrisin koston financiare të biznesit.

- Të konsiderojë konvertimin e borxhit afatshkurtër në borxh afatgjatë dhe nëse efekti financiar do të ishte i favorshëm dhe i qëndrueshëm.
- Të reduktojë nivelin e inventarit jo-lëvizës ose inventarit “të vjetruar” dhe që nuk mund shitet ose përdoret më tej në procesin e prodhimit.

Në vazhdim, prezantohen treguesit e aftësisë paguese dhe përfitueshmërisë, duke bërë njëkohësisht edhe një interpretim të tyre në kontekstin e rastit studimor.

- Raporti i borxhit ndaj aktiveve – ky raport matë përqindjen e borxhit që kompania mban në raport me mjetet e saj. Vlera e këtij raporti më e madhe se 1 tregon se kompania ka më shumë borxhe sesa mjete. Në rastin e kompanisë së analizuar ky raport është nën 1, gati i njëjtë në të gjitha vitet e analizuara. Megjithatë, kompania përgjithësisht ka nivel të lartë financimi përmes borxhit dhe në këtë drejtim duhet të bëjë kujdes sidomos me pagesat në kuptim të kostove fikse sepse ato përfaqësojnë shkallë të lartë risku, madje mund të rezultojnë deri në falimentim.
- Raporti i borxhit ndaj kapitalit – ky raport matë masën financiare të kompanisë duke treguar se çfarë përqindje të borxhit dhe kapitalit përdor për të financuar aktivet e saj. Një numër i ulët sugjeron se ka rrezik më të ulët të përfshirë për kreditorët dhe siguri të fortë financiare afatgjate. Në rastin e kompanisë në fjalë ky raport është i ulët dhe relativisht i njëjtë në të gjitha 5 vitet me një ulje shumë të vogël nga viti 2012 me vlerë prej 2,86 deri në vitin 2016 me 2,24.
- Fitimi marzhinal bruto – në rastin konkret kompania në vitin 2012 ka pasur një raport marzhinal bruto me 33% i cili nga viti në vit ka pësuar rënie. Kjo rënie vjen si pasojë e uljes së shitjeve dhe rritjes së kostos së mallrave të shitura, që domethënë se firma ka shtuar shpenzimet e saj për furnizim të lëndës së parë. Ndërsa, në anën tjetër kemi ulje të shitjeve të saj në përgjithësi. Kjo nuk është e favorshme për kompaninë dhe e njëjta duhet të rishqyrtojë edhe njëherë çmimet e lëndës së parë të produkteve si dhe të krijojë mënyra të reja për të rritur nivelin e shitjeve.
- Fitimi marzhinal operativ – në rastin konkret ky raport në vitin 2012 ka qenë 11% ndërsa në vitin 2013 kemi rritje prej 5%. Pas kësaj kemi rënie shumë të madhe në vitin 2014 me 12% e cila fillon të rritet në vitet 2015 dhe 2016 duke u bërë 13% në vitin 2016. Ulja e shitjeve në vitin 2014 në vlerë prej 15.082.000 denarë ka ndikuar në uljen e fitimit operativ marzhinal duke çuar këtë raport nga 12% në vitin 2013 në 4% në vitin 2014. Rritja e viteve pasuese ka ardhur si pasojë e uljes graduale të shpenzimeve operative të kompanisë.
- Fitimi marzhinal neto – në rastin konkret kompania ka ngritje dhe ulje të këtij raporti. Raport më të mirë ka pasur në vitin 2013 ku kemi edhe rritje të shitjeve në një vlerë të konsiderueshme nga 145 milion denarë në 161 milion denarë. Ndryshimi i nivelit të shitjeve ka ndikuar edhe në ndryshimet e nivelit të këtij raporti. Shenjë e mirë është fakti se kompania pas vitit 2014 ka filluar të përmirësojë performancën e saj duke e rritur raportin në 7% në vitin 2016.

- ROA apo kthimi në mjete – është një tregues i asaj sesa fitimprurës një kompani është ndaj mjeteve gjithsej. Kompania e analizuar ka pasur një raport prej 5% si në vitin 2012 ashtu edhe në vitin 2013. Pastaj në vitin 2014 si pasojë e uljes së fitimit të kompanisë nga 16 milion denarë në 2013 në 5 milion denarë në 2014, kemi ulje të këtij raporti. Por, pas vitit 2014 me përmirësimin e fitimit kemi një rritje graduale të këtij raporti.
- ROE apo kthimi në kapital – është raport i të ardhurave neto ndaj kapitalit dhe në rastin konkret njëjtë sikurse me raportin e mëparshëm ROA, edhe këtu në vitet e para shënohet një raport relativisht i lartë. Pastaj, një rënie në vitin 2014 ku ky raport është 5% dhe fillon të rritet në vitet në vazhdim. Kjo është shenjë e mirë pasi që tregon se kompania në rastin konkret ka filluar të përmirësohet.

5. PËRFUNDIME, REKOMANDIME DHE KUFIZIMET E STUDIMIT

5.1. Përfundime në kontekst të rastit studimor

Qëllimi i këtij studimi ishte që të vlerësojë gjendjen dhe performancën financiare për subjektin dhe periudhën e përzgjedhur nga perspektiva e vendimmarrjes menaxheriale. Punimi shpalosi rezultate të rëndësishme duke përdorur të dhënat empirike dhe një metodologji të caktuar dhe mirënjohur në fushën e analizës së pasqyrave financiare. Megjithatë, përdorimi i informacionit kontabël ose përgjithësisht i analizës së pasqyrave financiare dhe ndikimi i tij në marrjen e vendimeve të ndryshme u prezantua edhe nga një këndvështrim tjetër, respektivisht edhe nga gjykimi dhe opinioni përkatës përmes intervistimit të punësuarve. Ndonëse forma e pyetësorit ka edhe kufizimet e veta, rezultatet e fituara dhe të kombinuara me rezultatet e analizave tjera mund të shërbejnë në nxjerrjen e disa përfundimeve dhe rekomandimeve më të sakta.

Vendimet e investimeve dhe financiare janë të pakthyeshme pasi merren dhe ato janë thelbësore, sidomos kur bisedohet në terma afatgjatë. Si të tilla, është e nevojshme që të analizohen raportet – treguesit financiarë para çdo investimi dhe kjo përbën një sfidë për shumë biznese, përfshirë këtu edhe subjektin afarist të zgjedhur për analizë në kuadër të këtij punimi master.

Në mënyrë të përmbledhur studimi sugjeron për rastin studimor se ajo që ngelë sfidë në të ardhmen është që përdoruesit e informacionit financiarë dhe sidomos ato të brendshëm, menaxherët në këtë rast duhet përfundimisht të binden për rëndësinë dhe peshën reale që kontabiliteti dhe informacionin që ai gjeneron në vendimmarrjen afariste dhe financiare.

Duke analizuar të dhënat e mara nga pasqyrat financiare për kompaninë mund të vërejmë se kemi pasur lëvizje poshtë lart të zërave të ndryshëm si në bilancin e gjendjes ashtu edhe në atë të suksesit. Mbase në kuadër të treguesve që lidhen me bilancin e gjendjes është më vështirë të nxirret një konstatim në lidhje me përkeqësimin apo përmirësimin e gjendjes për shkak edhe të variacionit të shumave, por edhe se efektet ekonomike dhe financiare manifestohen edhe për periudha më të gjata. Gjithsesi, rezultatet treguan për shembull se në vitin 2014 në krahasim me vitin paraprak qarkullimi i mjeteve ishte ulur me 10%, ose ende më keq është performanca e matur përmes treguesve agregat si ROA ku ulja është 73% dhe ROE me ulje prej 72%.

Andaj, studimi tregoi se viti më kritik i kompanisë ka qenë viti 2014 ku kemi rënie të shumë zërave sikurse ajo e shitjeve si dhe fitimitgjithsej të kompanisë. Por po në këtë vit, respektivisht në fund të këtij viti, është investuar në themelimin e supermarketit Prima Center. Pas këtij viti kemi një rritje të nivelit të profitabilitetit të kompanisë si dhe të likuiditetit të saj. Për shembull, vetëm një vit pas respektivisht në vitin 2015 raporti i parasë rritet në 0.14 në krahasim me 0.02 në vitin paraprak, pra një rritje prej 600%. Kjo konfirmon njëherë hipotezën e dytë se themelimi i supermarketit Prima Center ka përmirësuar gjendjen dhe performancën financiare të kompanisë në fjalë.

Nga e gjitha analiza vërejmë se kompania edhe përkundër rënies në vitin 2014, ka arritur të përmirësojë gjendjen me hapa ndoshta të vogël por të sigurt. Megjithatë, diçka që duhet të

rishqyrtohet shumë me kujdes nga menaxhmenti i kompanisë është likuiditeti, pasi sipas treguesve financiarë kemi një gjendje jo të kënaqshme.

Treguesit financiarë përgjithësisht lëvizin nga viti në vit dhe kjo dëshmon se biznesi po operon në një ambient dinamik ku parashikimi financiar është mjaft i vështirë dhe kompleks. Në këtë drejtim sugjerohet që biznesi të harton politika të tilla që do ju përgjigjen sfidave të jashtme dhe njëkohësisht do të jenë në harmoni me përmirësimin e likuiditetit dhe profitabilitetit.

Me qëllim që të trajtojë këto probleme kompania duhet të ndryshojë politikat financiare. Duhet të rishikojë politikat e menaxhmentit financiarë, kryesisht që kanë të bëjnë me politikat e kredisë dhe shitjeve për të përmirësuar problemin me likuiditetin.

Pra, punimi përmes analizave sasiore të të dhënave kontabël tregoi se investimi afatgjatë – themelimi i supermarketit Prima Center ka përmirësuar përgjithësisht gjendjen financiare dhe performancën financiare të kompanisë Molika.

Më tej, në bazë të analizës së pyetësorit përgjithësisht menaxherët kanë bërë vlerësimin e gjendjes dhe performancës financiare në vendimmarrje gjatë periudhës 2012-2016. Në mbështetje të kësaj janë edhe rezultatet apo treguesit financiarë që dëshmojnë një përmirësim sidomos pas investimit afatgjatë të realizuar nga biznesi. Mbase mund të thuhet se vlerësimi ka ekzistuar si i tillë, por jo në nivel të konsiderueshëm dhe cilësor (disa tregues financiarë nuk lënë shumë për të dëshiruar).

Megjithatë, për të investuar në Prima Center përveç analizës dhe informacionit financiarë, analizës së tregut dhe parametrave të tjerë është vendosur edhe në bazë të vetë pronarit i cili zotëron aftësi afariste dhe menaxheriale pasi që disponon disa biznese të sektorëve të ndryshëm. Ky interpretim del edhe nga gërshetimi i rezultateve – gjetjeve të pyetësorit dhe mund të themi se pronari ka realizuar njëvendimmarrje-investim me risk të lartë, por që kthimi e arsyeton të njëjtin. Investimi në fjalë po dëshmohet se ishte profitabël si për kompaninë Molika të cilës i ndihmoi në kalimin e krizës, por gjithashtu edhe supermarketi Prima Center funksionon shumë mirë.

5.2. Rekomandime në kontekst të rastit studimor

Përmirësimi i gjendjes dhe performancës financiare nuk duhet të kuptohet dhe trajtohet si një vendim ad-hoc, por gjithsesi duhet të trajtohet dhe zbatohet në një plan afatgjatë dhe duhet të jetë një proces i vazhdueshëm.

Zhvillimi dhe avancimi i raportimit financiar në funksion tëvendimmarrjes menaxheriale duhet më tej të trajtohet. Informacioni kontabël nuk duhet të kuptohet dhe përpilohet vetëm për organet tatimore, por duhet ti shërbejë nëradhë të parëvendimmarrjes menaxheriale të subjektit në fjalë. Madje, ky informacion financiar duhet të jetë në formën dhe përmbajtjen sipas kërkesave menaxheriale.

5.3. Rekomandime për studim të mëtejshëm

Me interes për studimet e ardhshme do të ishte që gjendja dhe performanca financiare të vazhdon të ndiqet dhe analiza të thellohet në kuptim të informacionit ende më analitikë.

Një analizë e tillë do të nënkuptonte edhe vlerësimin, matjen dhe analizën sipas sektorëve apo produkteve duke shfrytëzuar një metodologji ende më të avancuar.

5.4. Kufizimet e studimit

Mungesa e një raportimi ende më cilësor/avancuar dhe të qëndrueshëm të brendshëm kontabël që realizohet kryesisht nga kontabiliteti menaxherial pamundëson thellimin e analizave të mëtejshme financiare dhe kështu edhe këtij studimi master.

Studimi është mbështetur kryesisht në informacionet-të dhënat e publikuara nga kontabiliteti financiarë dhe në disa raste ato janë të pamjaftueshme në realizimin e analizave më të avancuara financiare dhe kontabël.

BIBLIOGRAFIA

Citimet:

- CLAUSEN, J. (2009). Accounting 101- Income Statement: Financial Reporting and Analasys of Profit and Loss.
- GUMMESSON, E. (2000). Qualitative Methods in Management Research.
- HORRIGAM, J. O. (1968). A Short History of Financial Ratios Analysis, Accounting Review(3 ed., Vol. 43).
- LEWIS Mandell & THOMAS J. O'Brien. (1992). Investemnts.
- MTETWA, M. (2010). Fixed Assets:Capital Expenditure.
- NELGADDE, J. (2010). Inventory Analysis:A Guide to Analyzing Inventory for Small Business Owners.
- RAPPAPORT, A. (1974). Financial Statement Analysis. Englewood Cliffs, New Jersey: Prentice Hall.
- REILLY, F. K. (1989). Investment Analysis and Portfolio Management (3 ed.).
- STANLEY BLOCK, GEOFFREY HIRT, DOUG SHORT. (1998). Foundations of Financial Management (8 ed.).
- TRACY, J. A. (2004). How to Read a Financial Report:Wringing Vital Signs Out of the Numbers. John Wiley and Sons.
- THACHAPPILLY, G. (2009). Financial Ratio Analysis for Performance Check: Financial Statement Analysis with Ratios Can Reveal Problem Areas.
- XHAFA, P. (2005). Drejtimi Financiar. Tiranë.
- XHAFA, P. (2008). Analiza e Pasqyrave Financiare. Tiranë.

Literatura e shfrytëzuar–konsultuar dhe citimet:

- CLAUSEN, JAMES, “Accounting 101 – Income Statement: Financial Reporting and Analysis of Profit and Loss”, 2009.
- CLAUSEN, JAMES. “Accounting 101 – Financial Statement Analysis in Accounting: Liquidity Ratio Analysis Balance Sheet Assets and Liabilities”, 2009.
- CLAUSEN, JAMES. “Basic Accounting 101 – Asset Turnover Ratio: Inventory, Cash, Equipment and Accounts Receivable Analysis”, 2009.
- DIANE, WHITE., “Accounts Receivable: Analyzing the Turnover Ratio”, 2008.
- DINCA, M. S., BARBUTA-MISU, N., MADALENO, M., DINCA, GH., DEARI, F., “Integrated Analysis of EU Construction Companies’ Financial Performances”, Journal of Construction Engineering and Management, June 2017, Volume 143, Issue 6.
- FRANK K. REILLY. “Investment Analysis and Portfolio Management”, 1989, edicioni 3, shtypi The Dryden.
- GUMMESSON EVERT, “Qualitative Methods in Management Research”, 2000.
- HUTCHINSON, JAMES, “Long Term Debt to Equity Ratio of a Business: Understand a Company’s Value to its Investors and Owners”, 2010.

- JENKINS, LUCIA. "Contribution Margin and Breakeven Analysis: Determining When a Company will Realize a Profit", 2009.
- KENT. R., "Marketing Research: Approaches, Methods and Applications in Europe", 2007, Londër, Angli. Thomson Learning.
- LEWIS MANDELL & THOMAS J. O'BRIEN, "Investments", 1992. Macmillan Publishing Company, New York.
- MADALENO, M., MISU, B. N., DEARI, F., "Determinants of Net Trade Credit: A Panel VAR Approach Based on Industry", Prague Economic Papers, 2019, 28(3), f. 330-347.
- MARSHALL, D., MCMANUS, W., VIELE, D. "Managerial Accounting and Cost-Volume-Profit Relationships. Accounting: What the numbers mean", 2003, New York, edizioni 6.
- MERIC, I., MERIC, G. "A comparison of the financial characteristics of U.S. and Japanese manufacturing firms", Global Finance Journal, Volume 5, Issue 2, 1994, f. 205-218.
- MTETWA, MUNYA. "Fixed Assets: Capital Expenditure", 2010.
- NELGADDE, JO. "Accounts Receivable Analysis: A Guide to Analyzing Trade Debtors for Small Business Owners", 2010.
- NELGADDE, JO. "Debt Collection and Debt Recovery Tools: Using Credit Insurance and Debt Collection Agencies", 2010.
- NELGADDE, JO. "Inventory Analysis: A Guide to Analyzing Inventory for Small Business Owners", 2010.
- RAPPAPORT, ALFRED. "Financial Statement Analysis", 1974. Englewood Cliffs, New Jersey. Prentice Hall.
- TRACY, JOHN A. "How to Read a Financial Report: Wringing Vital Signs Out of the Numbers", John Wiley and Sons, 2004.
- THACHAPPILLY, GOPINATHAN. "Liquidity Ratios Help Good Financial Management: Liquidity Analysis reveals likely Short-Term Financial Problems", 2009.
- THACHAPPILLY, GOPINATHAN. "Profitability Ratios Measure Margins and Returns: Profit Ratios work with Gross, Operating, Pretax and Net Profits", 2009.
- THACHAPPILLY, GOPINATHAN. "Financial Ratio Analysis for Performance Check: Financial Statement Analysis with Ratios Can Reveal Problem Areas", 2009
- WEYGANDT, J. J, KIESO, D. E, & D, WARFIELD TERRY. "Intermediate Accounting", 2001, edizioni i 10, Bearcat Company, Vol-1.
- ZAIN. MARIA. "How to Use Profitability Ratios: Different Types of Calculations that Determine a Firm's Profits", 2008.
- OSADDY, E.A, AKHMETSHI, E.M, AMIROVA, E.F, BOCHKAREVA, T.N, GAZIZYANOVA, YO.YO, YAMSHEV, A.V., "Financial Statement of a Company as an Information Base for Decision-Making in a Transforming Economy", European Research Study Journal, Vol.XXL, Issue 2, 2018, fq. 339-350.
- AYAD SHAKER SULTAN, "Financial Statements Analysis-Measurement of Performance and Profitability. Applied Study of Baghdad Soft-Drink Industry", Economics, Research Journal of Finance and Accounting, Vol.5, No.4, 2014.

PAVITHRA, J., GURUKRISHAN, D., “A Study on Financial Analysis of BSNL”, International Journal of Pure and Applied Mathematics, Vol.119, No.12, 2018, fq.1471-1489.

PAVITHRA, J., THOYAMANI, K.P., DKHAR, K., “A Study on the Analysis of Financial Performance with reference to JEPPIAAR CEMENTS PVT LTD.”, International Journal of Pure and Applied Mathematics, Vol.116, No.14, 2017, fq.189-194.

Publikime elektronike dhe të dhënat brendshme:

____. DAVID SHAPIRO, “The Delicate Balance between Account Payables and Receivables” 2009, <<http://www.openforum.com/idea-hub/topics/money/article/the-delicate-balance-between-account-payables-and-receivables-david-shapiro>>.

____. Pasqyrat financiare të firmës “Molika, sh.p.k.” Tetovë, 2012-2016.

____. Të dhëna financiare, kontabël dhe tjera për firmën “Molika, sh.p.k.” Tetovë, 2012-2016.

____. www.molika-te.com.mk.

____.<http://businesscasestudies.co.uk/business-theory/finance/investment-decisions.html#axzz2ZCUfMwwW>.

____.<http://www.slideshare.net/hemanthcrpatna/a-stuy-on-interpretation-and-analysis-of-ratio-analysis-and-performance-evaluation-conducted-at-kmf>.

____.JAMES O. Horrigan, “A Short History of Financial Ratio Analysis”, The Accounting Review, 1968, Vol. 43, Nr. 2.

PYETËSORI

Kam nderin që të ua prezantoj juve këtë pyetësor. Qëllimi i këtij pyetësori është që të kuptojmë rolin e pasqyrave financiare në marrjen e vendimeve në kompani. Ju lutemi që të përgjigjeni në pyetjet pasi që ato do më ndihmojnë në punimin tim të masterit.

1. Çfarë gjinie jeni?

- a) M
- b) F

2. Cili është niveli juaj i arsimimit?

- a) Ulët
- b) Mesëm
- c) Lartë
- d) Tjetër_____

3. Cili është profesioni dhe detyra/pozita në kompaninë Molika?

4. Sa gjatë keni që punoni në kompaninë Molika?

- a) më pak se 2 vite
- b) 2-5 vite
- c) Më tepër se 5 vite

5. A jeni i njoftuar për gjendjen dhe performancën financiare të kompanisë?

- a) Po
- b) Jo
- c) Pak
- d) Shumë

6. A mund të përpilosh pasqyrat financiare?

- a) Po
- b) Jo
- c) Disi
- d) Shumë

7. Sa shpesh përpilohen pasqyrat financiare në kompaninë tuaj?
- a) 3 Muaj
 - b) 6 Muaj
 - c) 1 Vit
 - d) Nuk jam i informuar
8. A keni pasur rast të lexoni pasqyrat financiare të kompanisë?
- a) 1 herë brenda vitit
 - b) 2 herë brenda vitit
 - c) Tjetër
9. A jeni i vetëdijshëm për avantazhet e përpilimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar?
- a) Po
 - b) Jo
 - c) Pak
 - d) Shumë
10. A ju furnizon kompania me informata financiare në lidhje me vendimmarrjen?
- a) Po
 - b) Jo
 - c) Pak
 - d) Shumë
11. A merren parasysh analizat e pasqyrave financiare kur merren vendime të rëndësishme për kompaninë?
- a) Po
 - b) Jo
 - c) Pak
 - d) Shumë
 - e) Nuk jam i informuar
12. A jeni në gjendje t'i kuptoni pasqyrat financiare?
- a) Po
 - b) Jo
 - c) Pak
 - d) Shumë

13. A keni kërkuar nga shërbimi i kontabilitetit informata që ndihmojnë në vendimmarrje?
- a) Po
 - b) Jo
14. A bëni vlerësim të gjendjes dhe performancës financiare në kompani?
- a) Po
 - b) Jo
15. A shfrytëzohen informacionet e kontabilitetit në vendosjen e planeve, objektivave dhe qëllimeve të kompanisë?
- a) Po
 - b) Jo
 - c) Pak
 - d) Shumë
 - e) Nuk jam i informuar
16. A bëni analizë të pasqyrave financiare?
- a) Po
 - b) Jo
 - c) Nuk jam i informuar
17. Nëse pyetja 16 është po atëherë sa herë
- a) 1 herë në vit
 - b) 2 herë në vit
 - c) 3 herë në vit
 - d) Më shumë se 3 herë në vit
18. Sa ju besoni informacioneve të kontabilitetit?
- a) Pak
 - b) Shumë
 - c) Aspak
19. A i konsideroni informacionet e kontabilitetit të rëndësishme dhe të dobishme në vendimmarrje?
- a) Po
 - b) Jo
 - c) Pak
 - d) Shumë

20. A merren këshilla nga ekspertët e jashtëm për qëndrueshmërinë dhe zhvillimin ekonomik të kompanisë?

- a) Po
- b) Jo
- c) Nuk jam i informuar

21. Nëse përgjigjja e pyetjes 20 është po atëherë sa herë brenda vitit?

- a) 1 herë në vit
- b) 2 herë në vit
- c) 3 herë në vit
- d) Më shumë se 3 herë në vit

22. A janë të përmirësuara planet dhe vendimmarrja si rezultat i analizës të pasqyrave financiare?

- a) Po
- b) Jo
- c) Pak
- d) Shumë
- e) Nuk jam i informuar

23. Nëse kryeni analizë të pasqyrave financiare cilën teknik e përdorni?

- a) Metoda Horizontale
- b) Metoda Vertikale
- c) Metoda e Trendit
- d) Raportet Financiare
- e) _____tjetër

24. A i merrni informacionet në kohë?

- a) Po
- b) Jo

25. A arrini të krahasoni veten tuaj me konkurrentët?

- a) Po
- b) Jo
- c) Nuk jam i informuar

26. A u jepni informata përdoruesve të jashtëm (Kreditorët, Furnitorëve etj.)

- a) Po
- b) Jo
- c) Me raste
- d) Tjetër

27. A ndihmon analiza e pasqyrave financiare në gjetjen e zgjidhjes më të mirë për investime të ardhshme?

- a) Po
- b) Jo
- c) Pak
- d) Shumë
- e) Tjetër

28. A rishikohen në mënyrën e duhur elementet financiare para se të merren vendime financiare?

- a) Po
- b) Jo
- c) Pak
- d) Shumë
- e) Tjetër

29. Sa janë të sakta dhe adekuate informacionet financiare që i merr menaxhmenti?

- a) Pak
- b) Shumë
- c) Aspak
- d) Tjetër

30. Çfarë mendoni për hipotezat e punimit, a ja ka vlejtur investimi afatgjatë dhe cilët janë përfitimet/kostot? Komento përgjigjen.
